



USHTRIA



Viti i 79-të i botimit Nr. 12 (827968)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 27 mars 2026



Rritje historike për Forcat e Armatosura: Buxheti +12% dhe paga e ushtarit bazë, drejt rritjes me 70%

» faqe 3



PËRFUNDOI ME SUKSES "JUNIOR COMMAND AND LEADERSHIP COURSE (JCLC)", NË FORCËN TOKËSORE

Në ambientet e Shkollës së Trupës së Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit "Junior Command and Leadership Course (JCLC)", një program intensiv katër javor, i fokusuar në përgatitjen e liderëve të rinj ushtarakë. Në këtë kurs morën pjesë 33 kursantë të Kursit Bazë të Oficerit, të specialitetit këmbësori, të ardhur nga struktura të ndryshme të Forcave të Armatosura. Gjatë trajnimit, ata përfituan njohuri të avancuara dhe aftësi praktike...

faqe 4



METEOROLOGJIA USHTARAKE, 71 VITE SAKTËSI DHE BESUESHMËRI

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në shërbim të sigurisë nga qielli, portreti i një oficerije që lexon motin për misionin. Në një realitet ku çdo vendim operacional mund të ndikohet nga një ndryshim i papritur i motit, roli i meteorologjisë ushtarake bëhet thelbësor për suksesin e misioneve dhe sigurinë e forcave në terren. Nga pista e avionëve te operacionet tokësore e detare, çdo parashikim i saktë përkthehet në jetë të mbrojtura dhe vendimmarrje më të sigurta. Në këtë kuadër...

faqe 6



NGA HISTORIA, SOT: SHQIPËRIA, NJË MODEL GATISHMËRI NË ALEANCËN E NATO-s

Në një kohë kur sfidat globale të sigurisë po bëhen gjithnjë e më komplekse, një sondazh i fundit i publikuar nga Instituti Amerikan "Foreign Policy Research" sjell një lajm domethënës për Shqipërinë: 69 për qind e qytetarëve shqiptarë shprehen të gatshëm të luftojnë për vendin e tyre. Ky rezultat e rendit Shqipërinë në vendin e dytë mes vendeve anëtare të NATO-s, menjëherë pas Turqisë dhe përpara një sërë shtetesh të zhvilluara europiane si Suedia...

faqe 9

LEKSIONE TË NIVELIT TË LARTË NË KOLEGJIN E MBROJTJES DHE SIGURISË: FOKUS TE SIGURIA MODERNE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në ambientet e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), në kuadër të programit mësimor për vitin akademik 2025–2026, u zhvilluan një sërë leksionesh me rëndësi të veçantë, të cilat sollën në vëmendje zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Aktivitetet mblodhën kursantët e KLO-së, KKSHP-së dhe Departamentit të Gjuhëve të Huaja, si dhe stafin akademik, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për shkëmbim njohurish dhe përvojash profesionale.

Një ndër momentet kryesore ishte leksioni i mbajtur nga Francesco Saverio Agresti, Drejtor i Institutit për Studime të Larta të Mbrojtjes në Romë. Në prezantimin e tij me temë “Informim mbi aktivitetin e Institutit të Studimeve të Larta”, ai paraqiti strukturën, misionin dhe programet akademike të institucionit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në programe të avancuara studimi.

Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Altin Kurti, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Në vijim, u zhvillua një takim dypalësh mes gjeneral brigade Kurti dhe gjeneralmajor Agresti, ku u diskutuan mundësitë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit akademik ndërinstitutional.

Në kuadër të Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16), pjesëmarrësit ndoqën gjithashtu një leksion nga Vullnet Doka, Këshilltar i Presidentit të Republikës, me temë “Ndërtimi i qëndrueshmërisë ndaj kërcënimeve hibride dhe roli i sigurisë bashkëpunuese në Ballkanin Perëndimor”. Leksioni trajtoi sfidat aktuale të sigurisë dhe rëndësinë e një qasjeje të koordinuar rajonale për përballimin e tyre.



Një tjetër temë me interes të lartë ishte ajo mbi inteligjencën artificiale në sigurinë globale. Leksioni “Inteligjenca Artificiale dhe roli i saj në sigurinë globale dhe paqen” u mbajt nga Daniela Irrera, nga Qendra e Studimeve të Larta të Mbrojtjes (CASD), Romë. Ajo ofroi një analizë të thelluar mbi ndikimet e teknologjisë në transformimin e mjedisit të sigurisë ndërkombëtare, duke evidencuar si sfidat ashtu edhe mundësitë që sjell zhvillimi i inteligjencës artificiale.



Leksionet u karakterizuan nga interes i lartë dhe ndërveprim aktiv mes pjesëmarrësve, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve analitike dhe strategjike të kursantëve.

Këto aktivitete dëshmojnë angazhimin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për të ofruar një arsimim cilësor dhe bashkëkohor, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe për të forcuar bashkëpunimin me partnerët strategjikë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



PROFESIONALIZËM DHE NDËRVEPRUESHMËRI E LARTË E TOGËS EOD NË MISIONIN E NATO-s NË LETONI

Efektivat e togës EOD (Explosive Ordnance Disposal) të Forcave të Armatosura shqiptare, të dislokuar në kuadër të Brigadës Shumëkombëshe të misionit të NATO-s në Letoni, vijnë të dëshmojnë standarde të larta profesionalizmi dhe përgatitjeje gjatë zhvillimit të stërvitjeve operacionale.

Gjatë këtyre aktiviteteve trajnuese, efektivët shqiptarë kanë treguar aftësi të avancuara teknike dhe taktike në identifikimin, sigurimin dhe asgjësimin e municioneve të paplasura, duke operuar në përputhje me procedurat dhe standardet më të mira të Aleancës.

Njëkohësisht, toga EOD ka demonstruar një nivel të lartë koordinimi dhe ndërveprueshmërie me kontingjentet e vendeve aleate pjesëmarrëse në mision, duke kontribuar në rritjen e efektivitetit operacional dhe sigurisë në terren.

Pjesëmarrja në këtë mision shumëkombësh përbën një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale të personelit shqiptar, duke konsoliduar më tej rolin e Forcave të Armatosura në operacionet ndërkombëtare dhe angazhimet në kuadër të Aleancës.

Ky angazhim është një dëshmi konkrete e përkushtimit dhe aftësisë së efektivëve shqiptarë për të përmbushur me sukses detyrat në mjedise komplekse operacionale, duke përfaqësuar me dinjitet vendin dhe Forcat e Armatosura në arenën ndërkombëtare.



VIZITË PUNE E KOMANDANTIT TË FORCËS TOKËSORE NË KFOR

Komandanti i Forcës Tokësore, Petrit Çuni, zhvilloi një vizitë pune në Komandën Rajonale Perëndimore në Pejë, në kuadër të misionit të KFOR.

Gjatë kësaj vizite, gjeneralmajor Çuni u takua me Komandantin e Komandës Rajonale Perëndimore, Federico Mora, me të cilin diskutoi mbi ecurinë e misionit dhe rolin e kontingjentit shqiptar në këtë strukturë shumëkombëshe. Në fokus të bisedimeve ishte vlerësimi i kontributit dhe performancës së efektivëve shqiptarë, si dhe angazhimi i vazhdueshëm i Shqipërisë në mbështetje të këtij misioni të rëndësishëm për sigurinë dhe stabilitetin në rajon.

Në fjalën e tij, gjeneralmajor Çuni theksoi se Forca Tokësore dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të vijojnë mbështetjen e tyre të pakushtëzuar në përmbushje të angazhimeve në kuadër të NATO-s, duke nënvizuar gjithashtu perspektivën për rritjen e kontributit në të ardhmen.

Në vijim të vizitës, ai u takua nga afër me efektivët e kontingjentit shqiptar të dislokuar në këtë mision, duke i përgëzuar për profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin e treguar në përmbushjen e detyrave operacionale.

Vizita e Komandantit të Forcës Tokësore në KFOR rikonfirmon angazhimin e Shqipërisë për të kontribuar në misionet ndërkombëtare dhe për të forcuar bashkëpunimin me aleatët në funksion të paqes dhe sigurisë në rajon.



Rritje historike për Forcat e Armatosura: Buxheti +12% dhe paga e ushtarit bazë, drejt rritjes me 70%

Kryeministri Edi Rama ka bërë të ditur një paketë të re masash në mbështetje të Forcave të Armatosura, duke synuar përmirësimin e ndjeshëm të trajtimit financiar dhe kushteve për personelin ushtarak në vend.

Mes të tjerash, kreu i qeverisë theksoi se me miratimin e buxhetit të vitit 2026, fondet për mbrojtjen janë rritur me afro 12% krahasuar me vitin paraardhës. Sipas tij, kjo rritje vjen në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të NATO-s dhe synon garantimin e një trajtimi më dinjitoz për efektivet e Forcave të Armatosura.

“Kur miratuam buxhetin e vitit 2026, vendosëm t’i japim mbrojtjes afro 12% më shumë fonde sesa viti i mëparshëm, por edhe për t’i qëndruar zotimit për një trajtim gjithnjë e më dinjitoz të forcave tona të armatosura”, - u shpreh Kryeministri.

Në vijim të këtyre masave, Rama bëri të ditur se në fund të muajit shkurt është vendosur edhe rritja e pagave për ushtarakët, me efekt të drejtpërdrejtë që nga muaji janar. Po ashtu, në mbledhjen e fundit të qeverisë është miratuar edhe mbulimi i kostos së transportit për çdo ushtarak aktiv, një kërkesë e hershme e personelit në shërbim.

“Ky është një hap i shumëpritur dhe i mirëpritur nga të gjithë ata që, nën uniformën e Forcave tona të Armatosura, i shërbejnë vendit në çdo front”, - theksoi ai.

Kreu i ekzekutivit nënvizoi se objektivi strategjik i qeverisë është që deri në fund të mandatit, pagat e ushtarakëve shqiptarë të jenë konkurruese dhe të afrohen me nivelin mesatar të vendeve të Aleancës.

Në këtë kuadër, një nga synimet kryesore mbetet rritja e ndjeshme e pagës për ushtarin bazë.

“E thënë ndryshe, deri në fund të këtij mandati, paga e ushtarit bazë në Republikën e Shqipërisë synohet të rritet me deri në 70%”, - deklaroi Rama.

Këto masa konsiderohen një hap i rëndësishëm drejt



forcimit të kapaciteteve njerëzore të Forcave të Armatosura, duke rritur motivimin, mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e personelit ushtarak. Investimi në burimet njerëzore mbetet një nga shtyllat kryesore për rritjen e efektivitetit operacional dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe

ndërkombëtare në fushën e sigurisë.

Përmes kësaj pakete mbështetëse, qeveria synon të ndërtojë një sistem më të fortë dhe më të qëndrueshëm mbrojtjeje, duke vendosur në qendër vlerësimin dhe trajtimin e duhur të atyre që i shërbejnë vendit nën uniformë.

PËRFUNDON KURSI BAZË NË QENDRËN E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit bazë për nënoficerë, një moment i rëndësishëm në formimin profesional dhe nisjen e karrierës ushtarake për kursantët pjesëmarrës.

Ky kurs përfaqëson një etapë kyçe në përgatitjen e trupës së nënoficerëve, e cila konsiderohet një nga shtyllat kryesore për funksionimin efektiv dhe forcimin e kohezionit në çdo nivel njësie. Gjatë trajnimit, kursantët përfituan njohuri dhe aftësi thelbësore për përmbushjen e detyrave të tyre në strukturat e Forcave të Armatosura, duke u përgatitur për të marrë përgjegjësi të rëndësishme në terren.

Në ceremoninë përmbyllëse, e cila u zhvillua në një atmosferë solemne, u theksua rëndësia e rolit të nënoficerëve në garantimin e disiplinës, organizimit dhe efektivitetit operacional të njësive ushtarake. Pjesëmarrësit u përgëzuan për përkushtimin dhe rezultatet e arritura gjatë këtij formimi.

U vlerësua gjithashtu se përgatitja cilësore dhe mbështetja



e vazhdueshme e trupës së nënoficerëve përbëjnë një bazë të fortë për suksesin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura, në përputhje me standardet e NATO-s.

Përfundimi me sukses i këtij kursi shënon fillimin e një



rrugëtimi të ri profesional për kursantët, të cilët tashmë do të kontribuojnë si pjesë e rëndësishme e strukturave ushtarake, duke forcuar kapacitetet dhe gatishmërinë operationale të vendit.

Një delegacion i atasheve ushtarakë rezidentë dhe jorezidentë në vendin tonë zhvilloi një vizitë përnjohëse në Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) të Forcës Tokësore, me qëllim njohjen nga afër të strukturës, misionit dhe kapaciteteve operacionale të kësaj njësie.

Delegacioni përbëhej nga përfaqësues të disa vendeve aleate dhe partnere, përfshirë Polonia, Bullgaria, Gjermania, Italia, Greqia, Turqia dhe Republika Çeke, si dhe atasheu ushtarak jorezident i Bashkimit Evropian.

Gjatë vizitës, delegacioni u prit nga drejtuesit e batalionit dhe përfaqësues të lartë të Forcës Tokësore, të cilët prezantuan organizimin, detyrat kryesore dhe nivelin e përgatitjes së njësisë. Atasheve iu ofrua një panoramë e qartë mbi aftësitë operacionale dhe rolin e batalionit në përmbushjen e misioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.



Vizita u karakterizua nga një atmosferë bashkëpunimi dhe shkëmbimi përvojash profesionale, duke shërbyer si një mundësi e rëndësishme për forcimin e marrëdhënieve me aleatët dhe partnerët strategjikë. Përfaqësuesit e huaj vlerësuan nivelin e lartë të profesionalizmit dhe gatishmërinë operacionale të efektivëve të Forcës Tokësore.

Aktivitetet e tilla kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e ndërveprueshmërisë dhe konsolidimin e bashkëpunimit në kuadër të NATO-s, duke përforcuar angazhimin e Shqipërisë në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

VIZITË E ATASHEVE USHTARAKË NË BATALIONIN E KËMBËSORISË SË LEHTË TË FORCËS TOKËSORE



Përfundoi me sukses “JUNIOR COMMAND AND LEADERSHIP COURSE (JCLC)”, në Forcën Tokësore

Në ambientet e Shkollës së Trupës së Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit “Junior Command and Leadership Course (JCLC)”, një program intensiv katër javor, i fokusuar në përgatitjen e liderëve të rinj ushtarakë.

Në këtë kurs morën pjesë 33 kursantë të Kursit Bazë të Oficerit, të specialitetit këmbësori, të ardhur nga struktura të ndryshme të Forcave të Armatosura. Gjatë trajnimit, ata përfituan njohuri të avancuara dhe aftësi praktike në drejtim, vendimmarrje dhe lidërsip në nivel taktik, elementë thelbësorë për përmbushjen me sukses të detyrave operacionale.

Programi u realizua nga instruktorët e Shkollës së Trupës së Forcës Tokësore, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e British Military Advisory Training Team (BMATT), të cilët sollën eksperiencën dhe standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e trajnimit ushtarak. Ky bashkëpunim ndikoi drejtpërdrejt në rritjen profesionale të kursantëve dhe në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.

Ceremonia e përfundimit u nderua nga pjesëmarrja e përfaqësuesve të lartë vendas dhe ndërkombëtarë, mes tyre Zëvendësministri i Mbrojtjes, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ambasadori i Republikës Çeke, Atasheu Ushtarak Britanik, Shefi i Shtabit të BMATT, si dhe drejtues të lartë të Forcave të Armatosura, përfshirë Drejtorin e Shtabit të



Përgjithshëm dhe Zv/Komandanten e Forcës Tokësore.

Ky kurs përfaqëson një hap të rëndësishëm në përgatitjen e oficerëve të rinj, duke forcuar kapacitetet drejtuese dhe gatishmërinë operacionale të Forcave të Armatosura. Ai dëshmon gjithashtu angazhimin e vazhdueshëm për përmbushjen e standardeve të NATO-s dhe për përballimin me sukses të sfidave të mjedisit të sigurisë bashkëkohore.

Përmes programeve të tilla trajnimi, Forca Tokësore vijon të investojë në zhvillimin profesional të personelit të saj, duke ndërtuar një brez të ri liderësh të aftë, të përgatitur dhe të përkushtuar ndaj misionit në shërbim të vendit.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Një grua u vra nga bashkëshorti...”
“Një tjetër humb jetën nga ish-partneri...”
“Krim në familje...”
Këto fjali janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë mediatike. Ato nuk tronditin më si dikur. Nuk na ndalin më gjatë. I lexojmë, ndjejmë një keqardhje të shkurtër dhe vazhdojmë me jetën tonë. Pikërisht këtu qëndron rreziku më i madh: normalizimi i tragjedisë.
Kjo nuk është më vetëm kronikë e zezë. Është një sindromë shoqërore, një alarm i vazhdueshëm që po injorohet.

Nga lajm në fenomen
Vrasja e një gruaje nga partneri nuk është një akt i izoluar. Nuk është një shpërthim i momentit. Është fundi i një rruge të gjatë dhune, kontrolli dhe dominimi.
Termi “femicid” përdoret për të përshkruar pikërisht këtë fenomen, vrasjen e grave për shkak të gjinisë së tyre, shpesh nga njerëz me të cilët kanë pasur marrëdhënie intime. Kjo e bën tragjedinë edhe më të rëndë, sepse vendi që duhet të jetë më i sigurt, shtëpia, kthehet në vendin më të rrezikshëm.
Në realitetin tonë, këto raste po shtohen. Dhe bashkë me to, rritet edhe një ndjenjë e heshtur frike, sidomos tek gratë.

Dhuna që nis në heshtje
Asnjë krim nuk fillon me vrasje. Fillon me kontrollin: “Ku po shkon?”, “Me kë po flet?”
Vazhdon me izolimin: largimin nga miqtë, nga familja.
Pastaj vijnë fyerjet, poshtërimet, kërcënimet. Më pas, dhuna fizike.
Dhe në shumë raste, përfundimi tragjik.
Kjo është një spiralë që përsëritet në dhjetëra histori. Ajo që ndryshon janë vetëm emrat.
Shpesh, viktimat qëndrojnë në këto marrëdhënie jo sepse duan, por sepse nuk shohin rrugëdalje. Frika, varësia ekonomike, presioni shoqëror dhe mungesa e mbështetjes i mbajnë të bllokuara në një cikël të dhunshëm.

Shoqëria që hesht
Një nga faktorët më shqetësues është heshtja. Komshinjtë dëgjojnë zënka. Familjarët shohin shenja dhune. Miqtë vërejnë ndryshime në sjellje. Por shpesh askush nuk ndërhyjnë.
Fraza të tilla si “është çështje familjare” apo “do ta zgjidhin vetë”, janë bërë justifikime për indiferencën. Kjo kulturë heshtjeje i jep hapësirë dhunës të rritet.
Në këtë mënyrë, shoqëria bëhet, në mënyrë indirekte, bashkëfajtoare.

Roli i institucioneve mes ligjit dhe realitetit
Ligjet ekzistojnë. Ka mekanizma mbrojtjeje. Ka urdhra mbrojtjeje, procedura ligjore, struktura policore.
Por problemi qëndron në zbatimin e tyre.


Shpesh:

- Denoncimet nuk merren seriozisht
- Rreziku nuk vlerësohet si duhet
- Urdhrat e mbrojtjes nuk monitorohen

Ka raste kur viktimat kanë kërkuar ndihmë disa herë para se të ndodhë tragjedia. Dhe kjo e bën çdo humbje jete edhe më të rëndë – sepse ishte e parandalueshme.
Institucionet duhet të reagojnë me shpejtësi, ndjeshmëri dhe profesionalizëm. Çdo neglizhencë kushton jetë.

Media mes informimit dhe sensacionalizmit
Media ka një rol kyç në mënyrën si perceptohet ky fenomen.
Por shpesh, raportimi bie në grackën e sensacionalizmit: Theksohen detaje tronditëse. Përdoren terma si “krim pasioni”, analizohen sjelljet e viktimës.

Kjo qasje jo vetëm që nuk ndihmon, por edhe dëmton. Ajo zhvendos vëmendjen nga problemi real dhe krijon narrativa të rrezikshme.



Një lajm që nuk duhet të bëhet rutinë

Media duhet të:

- Edukojë publikun
- Theksojë përgjegjësinë e autorit
- Trajtojë viktimat me dinjitet

Sepse mënyra si tregohen këto histori ndikon drejtpërdrejt në mënyrën si shoqëria i kupton ato.

Rrënjët e problemit, kultura dhe mentaliteti
Dhuna ndaj grave nuk lind në boshllëk. Ajo është e lidhur me mënyrën si shoqëria e koncepton rolin e burrit dhe të gruas.

Në shumë raste:

- Kontrolli interpretohet si kujdes
- Xhelozia si dashuri
- Dominimi si autoritet
- Këto janë ide të rrezikshme që ushqejnë dhunën.

Në një shoqëri ku gruaja ende përballet me paragjykitime dhe pabarazi, dhuna bëhet më e lehtë për t'u justifikuar dhe më e vështirë për t'u denoncuar.

Edukimi si zgjidhje afatgjatë
Ndryshimi nuk vjen vetëm nga ligjet. Ai fillon nga edukimi.

Duhet të mësojmë:

- Respektin në marrëdhënie
- Barazinë gjinore
- Menaxhimin e emocioneve

- Refuzimin e dhunës

Fëmijët që rriten në një ambient të shëndetshëm kanë më pak gjasa të bëhen dhunues apo viktima në të ardhmen. Shkollat dhe familjet kanë një rol vendimtar në këtë proces.

Një thirrje për ndërgjegjësim dhe veprim
Ky fenomen nuk është thjesht problem i grave. Është problem i gjithë shoqërisë.

Çdo individ mund të bëjë diçka:

- Të mos heshtë
- Të raportojë dhunën
- Të mbështesë viktimat
- Të refuzojë justifikimet për dhunën

Sepse ndryshimi fillon nga vetëdija.

Mesazhi që nuk duhet të injorohet
Sa herë duhet të lexojmë të njëjtin titull?
Sa jetë duhet të humbasin që të reagojmë?

Çdo lajm i tillë nuk është thjesht një histori tragjike. Është një dështim kolektiv.

Dhuna nuk është normale. Heshtja nuk është zgjidhje. Indiferenca vret.

Nëse duam një shoqëri më të sigurt, duhet të fillojmë duke mos e pranuar më këtë realitet si të zakonshëm.

Sepse çdo grua meriton të jetojë dhe çdo jetë e humbur është një alarm.

METEOROLOGJIA USHTARAKE, 71 Vite Saktësi dhe Besueshmëri



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në shërbim të sigurisë nga qielli, portreti i një oficerije që lexon motin për mision

Në një realitet ku çdo vendim operacional mund të ndikohet nga një ndryshim i papritur i motit, roli i meteorologjisë ushtarake bëhet thelbësor për suksesin e misioneve dhe sigurinë e forcave në terren. Nga pista e avionëve te operacionet tokësore e detare, çdo parashikim i saktë përkthehet në jetë të mbrojtura dhe vendimmarrje më të sigurta. Në këtë kuadër, Shërbimi Meteorologjik Ushtarak ka evoluar në një komponent strategjik të Forcave të Armatosura, duke ofruar informacion jetik në kohë reale për operacionet luftarake dhe ato civile.

Në krye të këtij kontributi qëndron edhe figura e nënkolonel **Eglantina Muka**, një profesioniste e përkushtuar që ndër vite ka ndërtuar dhe konsoliduar profilin e saj në një nga fushat më delikate dhe të domosdoshme të mbrojtjes. Me një qasje analitike dhe një përvojë të gjatë në interpretimin e fenomeneve atmosferike, ajo përfaqëson modelin e oficeres që ndërthur shkencën me misionin ushtarak.

E qetë në komunikim, por e saktë në analizë, nënkolonel Muka mishëron profesionalizmin dhe përgjegjësinë që kërkon ky shërbim. Për të, moti nuk është thjesht një fenomen natyror, por një faktor vendimtar që duhet lexuar, kuptuar dhe parashikuar me përpikëri në funksion të operacioneve dhe sigurisë kombëtare.

Në këtë intervistë për gazetën “Ushtria”, ajo ndalet në rrugëtimin 71-vjeçar të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, sfidat e fillimit, transformimin teknologjik dhe rolin kyç që ky shërbim luan sot në mbështetje të Forcave të Armatosura dhe institucioneve të sigurisë.

Si lindi ideja për krijimin e Shërbimit Meteorologjik në Forcat e Armatosura?

Krijimi i Shërbimit Meteorologjik, në Forcat e Armatosura ishte rezultat i një vlerësimi strategjik të domosdoshmërisë për të integruar faktorin meteorologjik në planifikimin dhe realizimin e operacioneve ushtarake. Ideja për themelimin e këtij shërbimi lindi si një përgjigje ndaj nevojës për informacion të strukturuar, të besueshëm dhe në kohë reale mbi dinamikën e motit, veçanërisht në mbështetje të komponentëve kritikë si aviacioni ushtarak, operacionet detare dhe stërvitjet tokësore.

Cilat ishin sfidat kryesore në vitet e para të themelimit?

Në fazat e para të themelimit, sfidat kryesore lidhen me mungesën e kapaciteteve të specializuara njerëzore, kufizimet në infrastrukturën teknike dhe teknologjike, si dhe me mungesën e standardeve të konsoliduara operationale. Këto u shoqëruan me vështirësi në sigurimin dhe përpunimin e të dhënave meteorologjike, si dhe në integrimin e tyre në proceset vendimmarrëse ushtarake.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, përmes zhvillimit gradual të burimeve njerëzore dhe modernizimit të mjeteve teknike, u arrit konsolidimi i një shërbimi funksional dhe i besueshëm në mbështetje të operacioneve të Forcës Ajrore dhe Forcave të Armatosura.

Si ka evoluar ky shërbim gjatë 71 viteve të fundit?

Gjatë 71 viteve të fundit, Shërbimi Meteorologjik në Forcat e Armatosura ka kaluar nga një strukturë bazike me kapacitete të kufizuara vëzhgimi, në një sistem të integruar, të modernizuar dhe me rol strategjik në mbështetje të operacioneve ushtarake. Ky evolucion është karakterizuar nga kalimi nga metodat manuale drejt sistemeve të automatizuara dhe digjitale, rritja e saktësisë së parashikimeve përmes përdorimit të teknologjive të avancuara, si dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale dhe analitike.

Cilat janë momentet më të rëndësishme historike për këtë institucion?

Momentet kyçe të zhvillimit të Shërbimit Meteorologjik në

**N/Kolonel
Eglantina MUKA**



Forcat e Armatosura mund të konsolidohen në disa etapa kohore, të cilat kanë përcaktuar identitetin e këtij shërbimi:

23 mars 1955 – Themelimi i shërbimit meteorologjik dhe ngritja e strukturave të para organizative, duke institucionalizuar mbështetjen meteorologjike në funksion të operacioneve ushtarake.

1960–1980 – Konsolidimi i kapaciteteve bazë, zgjerimi i rrjetit të vëzhgimit dhe specializimi i personelit, duke vendosur themelet profesionale të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak.

1990 – Periudha e tranzicionit, e karakterizuar nga ristrukturimi institucional dhe përshtatja me standarde të reja në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

2000–2010 – Modernizimi teknologjik dhe fillimi i integritimit në sistemet ndërkombëtare të shkëmbimit të të dhënave meteorologjike, duke rritur ndjeshëm cilësinë e parashikimeve.

Pas vitit 2010 – Konsolidimi si kapacitet strategjik, me përdorimin e sistemeve të avancuara (modele numerike) dhe rritjen e rolit në mbështetje të operacioneve ushtarake dhe menaxhimit të emergjencave civile.

Këto etapa përfaqësojnë kalimin gradual nga një strukturë fillestare teknike drejt një sistemi të integruar, modern dhe me rëndësi të lartë strategjike në arkitekturën e sigurisë kombëtare.

Si ka ndikuar zhvillimi teknologjik në punën tuaj ndër vite?

Zhvillimi teknologjik ka transformuar rrënjësisht funksionimin e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, duke rritur ndjeshëm saktësinë, shpejtësinë dhe besueshmërinë e parashikimit të motit. Integrimi i sistemeve të automatizuara dhe modeleve numerike ka mundësuar monitorim në kohë reale dhe analizë të avancuar të të dhënave. Kjo ka forcuar rolin e shërbimit në mbështetje të vendimmarrjes strategjike dhe operationale. Në tërësi, teknologjia ka shndërruar shërbimin nga një funksion mbështetës në një kapacitet kyç të sigurisë dhe efektivitetit operacional.

Roli dhe misioni

Cili është roli kryesor i Shërbimit Meteorologjik në Forcat e Armatosura?

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak ka një rol të dyfishtë:

- Ushtarak: Mbështetje direkte me informacion meteorologjik Forcën Ajrore dhe Forcat e Armatosura me të dhëna të sakta dhe në kohë reale.
- Civil: Mbështetje me informacion meteorologjik AKMC,



Institucionet shtetërore dhe komunitetin.

- Misioni i Shërbimit Meteorologjik Ushtarak është: “Me kapacitetet e veta siguron informacion të nevojshëm të kushteve meteorologjike në interes të operacioneve luftarake dhe jo luftarake të Forcave të Armatosura dhe Forcës Ajrore në veçanti, të institucioneve të tjera dhe në interes të komunitetit”.

- Këtë rol dhe mision, ky shërbim e kryen në zbatim të ligjit nr. 9224, datë 29.04.2004 “Për Shërbimin Meteorologjik Ushtarak”, “Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimi Meteorologjik Ushtarak” si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Si kontribuon ky shërbim në sigurinë kombëtare?

Ky shërbim kontribuon në sigurinë kombëtare duke bërë të mundur:

- Paralajmërimin e rreziqeve natyrore, ku ky shërbim siguron informacion të saktë mbi parashikimin e fenomeneve meteorologjike që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë kombëtare, duke paralajmëruar institucionet e sigurisë kombëtare të marrin masa parandaluese për të minimizuar humbjet njerëzore dhe materiale.

- Mbështetjen e operacioneve ushtarake: Parashikimi i motit është vendimtar për planifikimin e manovrave ushtarake, transportit ushtarak, patrullimeve dhe operacioneve speciale. Kushtet atmosferike ndikojnë në përdorimin e pajisjeve, dronëve, avionëve dhe teknologjive të tjera.

- Planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen: Të dhënat meteorologjike janë bazë për hartimin e planeve kombëtare të emergjencës, përgatitjen ndaj katastrofave dhe menaxhimit e krizave, duke rritur qëndrueshmërinë dhe aftësinë e reagimit të shtetit.

Në çfarë mënyre ndihmon në planifikimin e operacioneve ushtarake?

Parashikimi i motit është një element kyç që ka ndikim të drejtpërdrejtë në operacionet ushtarake, si në fazën e planifikimit taktik ashtu dhe gjatë zhvillimit të operacioneve të Forcave të Armatosura, si dhe në veçanti të Forcës Ajrore (fluturime, stërvitje, SAR), duke bërë të mundur të merren masat e nevojshme për sigurinë e personelit dhe pajisjeve (parandalimi i aksidenteve për shkak të kushteve të rënduara meteorologjike).

Sa i rëndësishëm është parashikimi i motit për operacionet ushtarake?

Shërbimi Meteorologjik ndihmon në operacionet ushtarake

në mënyra të ndryshme, të fokusuara në sigurinë, efikasitetin dhe suksesin e misioneve nëpërmjet:

Vlerësimit të kushteve meteorologjike, informacion të detajuar të këtyre elementëve që ndikojnë për të vendosur për kohën dhe mënyrën e kryerjes së operacioneve. Kushtet e pafavorshme mund të shtyjnë ose modifikojnë mënyrën e kryerjes së operacioneve ushtarake, për të reduktuar rrezikun, pasi mjetet ajrore pa pilot, avionët, helikopterët (lëvizja e trupave dhe venddislokimi i tyre), si dhe sistemet elektronike varen shumë nga kushtet meteorologjike.

Si bashkëpunoni me strukturat e tjera brenda dhe jashtë vendit?

Bashkëpunimi i Shërbimit Meteorologjik me strukturat e tjera, brenda dhe jashtë vendit, realizohet në nivel strategjik, operativ dhe tekniko-profesional, duke synuar shkëmbimin e informacionit meteorologjik për të përmirësuar sigurinë kombëtare:

- Brenda vendit:** Shërbimi Meteorologjik bashkëpunon ngushtë sipas linjës së komandimit në FA, si dhe me Policinë e Shtetit, Emergjencat Civile dhe autoritetet lokale për koordinimin e parashikimeve dhe planeve të veprimit ndaj fenomeneve ekstreme. Ky bashkëpunim siguron që të dhënat meteorologjike të përdoren në kohë reale për vendimmarrje strategjike dhe operacionale.

- Jashtë vendit:** Bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet përmes organizatave meteorologjike si Organizata Botërore e Meteorologjisë si dhe qendrave rajonale siç është ajo e ‘Pratica di Mare’, Itali.

Teknologjia dhe pajisjet

Çfarë teknologjish moderne përdorni sot për monitorimin e motit?

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak është i përbërë nga një rrjet stacionesh meteorologjike të shpërndarë në të gjithë vendin me kod vendndodhje, gjerësi, gjatësi dhe lartësi mbi nivelin e detit të njohura Organizata Botërore e Meteorologjisë. Stacionet meteorologjike të këtij shërbimi janë stacione sinoptike klasike me personel, i cili kryen vrojtime dhe matje të elementëve meteorologjikë në 24 /7 për të përpiluar mesazhet meteorologjike si mesazhi Synop (që është i rëndësishëm për monitorimin e masave ajrore që shërben për të prodhuar modelet matematikore për parashikim e motit) edhe mesazhet Metar (që shërbejnë për aktivitetin e fluturimit). Këto mesazhe transmetohen në Qendrën Rajonale ‘Pratica Di Mare’, Romë, për t’u bërë pjesë e rrjetit global të të dhënave meteorologjike në kohë reale. Një pjesë e stacioneve meteorologjike të këtij shërbimi janë të pajisur edhe me stacione meteorologjike automatiqe.

Si janë përmirësuar metodat e parashikimit krahasuar me të kaluarën?

Metodat e parashikimit meteorologjik janë përmirësuar ndjeshëm krahasuar me të kaluarën, kryesisht në:

- Teknologji më të avancuara: Përdorimi i stacioneve automatiqe, satelitëve dhe sensorëve të specializuar ka rritur saktësinë dhe shpejtësinë e vrojtimeve.

- Modelime numerike dhe inteligjencë artificiale: Softuerët modernë që përdoren për parashikimin e motit integrojnë të dhëna që marrin si në rang rajonal ashtu edhe në atë global, duke përdorur algoritme komplekse për parashikime më të sakta.

- Shkëmbim ndërkombëtar i të dhënave: Bashkëpunimi me shërbime meteorologjike të huaja dhe qendra rajonale siguron informacion të përditësuar, duke rritur kapacitetin për të identifikuar dhe parashikuar fenomene ekstreme me kohë.

Në thelb, krahasuar me të kaluarën, parashikimi i motit sot është më i saktë, më i shpejtë dhe më i besueshëm, duke përdorur teknologjinë e avancuar, imazhet satelitore dhe gjithçka tjetër më të përparuar në teknologji.

A përdorni satelitë apo sisteme të automatizuara?

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak bashkëpunon me Qendrën Rajonale ‘Pratica Di Mare’, Romë, që është përgjegjëse për rajonin e VI (rajon në të cilin bënë pjesë edhe vendi ynë), duke shkëmbyer të dhënat dhe duke patur akses në modelet matematikore që shërbejnë për parashikimin e motit të prodhuara nga Qendra Rajonale për Parashikimin Afatmesëm (ECMWF) si dhe imazhet të ndryshme satelitore.

Sa i rëndësishëm është digjitalizimi në këtë shërbim? Digjitalizimi është i rëndësishëm, sepse siguron monitorim në kohë reale, integrim të të dhënave dhe reagim më të shpejtë ndaj fenomeneve meteorologjike duke:

- Mbledhur dhe përpunuar të dhënat meteorologjike në kohë reale: Sistemet automatiqe dhe sensorët e digjitalizuar mundësojnë monitorim të vazhdueshëm të parametrave meteorologjikë, duke minimizuar vonesat.

- Integruar të dhëna të shumta: Informacioni nga stacionet, radarët, satelitët dhe sistemet rajonale mund të kombinohet lehtësisht për parashikime më të sakta dhe analiza komplekse, duke mbështetur operacionet ushtarake, civile dhe emergjencat.

Si trajtohen të dhënat meteorologjike që mbledhen?

Të dhënat meteorologjike të këtij shërbimi kryejnë një cikël zinxhir deri në hapin përfundimtar, i cili është prodhimi i modeleve matematikore (harta sinoptike).

- Të dhënat meteorologjike që vrojtohen dhe regjistrohen në stacionet meteorologjike grumbullohen dhe regjistrohen në Sektorin e operacioneve meteorologjike.

- Këto të dhëna kontrollohen dhe transmetohen në formën e mesazheve meteorologjike (SYNOP dhe METAR) në Qendrën Rajonale.

- Më pas nga Qendra Rajonale bëhet analizimi dhe integrimi i tyre me të dhënat ndërkombëtare dhe rajonale (p.sh. EUMETSAT, qendrat rajonale si ‘Pratica di Mare’), për të gjeneruar modele numerike për parashikime dhe alarme meteorologjike.

- Në thelb, trajtimi i të dhënave siguron që çdo informacion meteorologjik të jetë i saktë, i integruar dhe i disponueshëm për përdorim strategjik dhe operacional.

Personeli dhe trajnimi

Çfarë kualifikimesh duhet të ketë një personel, i cili ushtron detyrën si specialist parashikimi në Shërbim Meteorologjik Ushtarak?

Një specialist parashikimi duhet të ketë një formim të plotë akademik në meteorologji, fizikë ose shkencë ekzakte, të shoqëruar me njohuri të thelluara mbi analizën sinoptike, modelet numerike dhe interpretimin e të dhënave atmosferike. Gjithashtu, duhet të zotërojë aftësi të forta analitike, saktësi në vendimmarrje, kompetencë në përdorimin e teknologjive dhe softuerëve meteorologjikë, si dhe aftësi për të operuar në kushte dinamike dhe shpesh nën presion.

Si përgatiten dhe trajnohen punonjësit tuaj?

Personeli i Shërbimit Meteorologjik Ushtarak përgatitet dhe trajnohet në mënyrë të vazhdueshme përmes një kombinimi të formimit teorik dhe praktik. Trajnimi i tyre përfshin pjesëmarrjen në programe të specializuara ndërkombëtare, si praktikat profesionale pranë institucioneve të njohura si ‘Pratica Di Mare’ në Romë, Itali, ku ata përfitojnë njohuri të avancuara dhe përvojë bashkëkohore në fushën e meteorologjisë. Paralelisht, zhvillohet edhe trajnimi në vendin e punës “on-the-job training”, i cili siguron përditësimin e vazhdueshëm të aftësive praktike, si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale në përmbushje të misionit. Kjo qasje e integruar garanton një nivel të lartë profesionalizmi dhe gatishmërie të personelit.

A ka bashkëpunime me institucione arsimore apo ndërkombëtare?

Po, institucioni ynë zhvillon bashkëpunime të qëndrueshme me partnerë arsimorë dhe ndërkombëtarë, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e njohurive bashkëkohore. Një komponent i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi është angazhimi në programe trajnimi dhe praktika profesionale pranë ‘Pratica di Mare’, Romë, Itali, ku personeli përfiton ekspertizë të avancuar në fushën e meteorologjisë ushtarake dhe detare.

Cilat janë sfidat më të mëdha për stafin tuaj në terren?

Sfidat më të mëdha për stafin në terren lidhen me kushtet e vështira atmosferike, nevojën për vendimmarrje të shpejtë dhe të saktë, si dhe funksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve në mjedise shpesh të paqëndrueshme.

Si ruhet profesionalizmi dhe gatishmëria në çdo kohë?

Profesionalizmi dhe gatishmëria ruhen përmes trajnimeve të vazhdueshme, përditësimit të njohurive dhe zbatimit rigoroz të standardeve dhe procedurave operacionale. Gjithashtu, monitorimi i performancës dhe ushtrimet periodike sigurojnë reagim të shpejtë dhe efektiv në çdo situatë.

Bashkëpunimi dhe misionet

A merr pjesë ky shërbim në misione ndërkombëtare?

Ky shërbim kontribuon në misione ndërkombëtare, duke ofruar ekspertizë dhe mbështetje meteorologjike, por në zbatim të Ligjit 9224/2004, veprimtaritë kryesore janë të kufizuara në parashikimin dhe analizën brenda territorit të vendit. Ai mbështet partnerët dhe operacionet ndërkombëtare përmes këshillimit profesional dhe shkëmbimit të të dhënave, pa ndërhyrje direkte operative jashtë kufijve kombëtarë.

Si bashkëpunoni me shërbimet meteorologjike civile?

Bashkëpunimi me shërbimet meteorologjike civile realizohet kryesisht në nivel këshillimi dhe shkëmbimi të informacionit të përgjithshëm, duke ruajtur kompetencat dhe përgjegjësitë e secilit institucion. Përmes dialogut të vazhdueshëm dhe koordinimit minimal, synohet sigurimi i një qasjeje të harmonizuar ndaj të dhënave dhe parashikimeve meteorologjike.

A ka pasur raste konkrete ku parashikimi juaj ka qenë vendimtar?

Informacioni meteorologjik ka qenë vendimtar në operacione që janë planifikuar, duke përfshirë aktivitetin e fluturimit dhe të mjeteve ajrore pa pilot, duke parashikuar ndryshime të papritura në elementët meteorologjikë që kanë ndikim në këtë aktivitet. Një rast konkret ishte gjatë një operacioni fluturimi ushtarak, kur informacioni meteorologjik i përgatitur nga Shërbimi Meteorologjik Ushtarak parashikoi ndryshime të papritura në intensitetin e erës dhe mundësi për formim të mjegullës. Bazuar mbi këto parashikime, u morën vendime për modifikimin e itinerarit dhe kohës së nisjes së fluturimeve, duke garantuar sigurinë e pilotëve dhe efektivitetin e misionit.

Si ndihmoni në situata emergjente apo fatkeqësi natyrore?

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak ndihmon në situata emergjente dhe fatkeqësi natyrore, duke ofruar parashikime të sakta dhe analiza meteorologjike në kohë reale, të cilat janë thelbësore për planifikimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve. Ai siguron informacion për rreziqet e mundshme atmosferike, duke mbështetur vendimmarrjen e autoriteteve dhe forcave operacionale për të minimizuar dëmet dhe për të garantuar sigurinë e qytetarëve. Në këtë mënyrë, meteorologjia bëhet një mjet strategjik për reagim të shpejtë dhe efektiv në çdo situatë kritike.

Sa i rëndësishëm është koordinimi me NATO-n apo organizata të tjera?

Koordinimi me NATO-n dhe organizata të tjera ndërkombëtare ka një rëndësi strategjike për shërbimin, pasi siguron harmonizimin e standardeve operacionale, shkëmbimin e informacionit meteorologjik në kohë reale dhe përmirësimin e planifikimit të misioneve. Ky bashkëpunim forcon kapacitetet institucionale, mundëson përgatitje të përbashkët për situata emergjente dhe rrit efektivitetin e

vendimmarrjes strategjike në operacione ndërkombëtare. Përmes këtyre mekanizmave, shërbimi kontribuon në konsolidimin e partneriteteve dhe sigurinë kolektive në nivel aleancash.

Sfida dhe zhvillime të ardhshme

Cilat janë sfidat kryesore që hasni sot?

Sfidat kryesore që hasim sot lidhen me përballimin e dinamikave gjithnjë e më komplekse të ndryshimeve klimatike dhe ndikimin e tyre në saktësinë e parashikimeve. Një tjetër sfidë thelbësore është modernizimi i vazhdueshëm i infrastrukturës teknologjike dhe integrimi i sistemeve të avancuara të të dhënave në kohë reale. Po ashtu, mbetet prioritet zhvillimi i kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve të specializuara, në mënyrë që të ruhet konkurrenca dhe përputhja me standardet ndërkombëtare.

Si po ndikon ndryshimi klimatik në punën tuaj?

Ndryshimi klimatik po ndikon drejtpërdrejt në kompleksitetin dhe pasigurinë e proceseve të parashikimit meteorologjik, duke rritur frekuencën dhe intensitetin e fenomeneve ekstreme atmosferike. Kjo kërkon përditësim të vazhdueshëm të modeleve numerike, integrim të të dhënave shumë-burimore dhe forcim të kapaciteteve analitike për të garantuar parashikime sa më të sakta dhe të besueshme. Në nivel institucional, kjo përkthehet në nevojën për investime strategjike në teknologji, dhe zhvillim profesional të burimeve njerëzore.

Çfarë planesh keni për modernizimin e mëtejshëm?

Aktualisht, jemi në fazat fillestare për modernizimin e Shërbimit, me synim që ai të arrijë standarde të barabarta me shërbimet meteorologjike të vendeve aleate. Përqendrimi ynë është në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, integrimin e sistemeve të avancuara të përpunimit të të dhënave dhe përditësimin e modeleve numerike për parashikime më të sakta. Njëkohësisht, zhvillojmë kapacitetet njerëzore përmes trajnimeve të specializuara dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, për të siguruar një nivel profesionalizmi dhe gatishmërie në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Si e shihni të ardhmen e këtij shërbimi në 10–20 vitet e ardhshme?

Në 10–20 vitet e ardhshme, shërbimi synon të bëhet një referencë rajonale për meteorologjinë ushtarake dhe civile, duke integruar teknologji të avancuara dhe analiza të thelluara të të dhënave meteorologjike. Vizioni strategjik përfshin forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, si dhe zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare për të garantuar standarde të barabarta me vendet aleate. Ky shërbim synon të konsolidojë rolin e tij si një institucion modern, profesional i vetëm dhe i besueshëm për parashikimin e motit në vendin tonë.

Çfarë investimesh janë më të nevojshme aktualisht?

Aktualisht, investimet më të nevojshme për shërbimin lidhen me ngritjen dhe modernizimin e rrjetit të transmetimit të të dhënave, automatizimi i rrjetit të stacioneve meteorologjike me teknologji bashkëkohore, duke siguruar mbledhje, transmetim dhe shpërndarje të informacionit meteorologjik në kohë reale, në përputhje me standardet ndërkombëtare për FA, FAj dhe të gjithë institucioneve në vend. Kjo do ta bënte këtë shërbim të funksionojë në nivel të barabartë me vendet aleate, duke ofruar profesionalizëm, gatishmëri operative dhe mbështetje të qëndrueshme për vendimmarrje strategjike.

Mesazhe dhe reflektime

Çfarë do të thotë për ju 71-vjetori i këtij shërbimi?

71-vjetori i këtij shërbimi përbën një moment reflektimi mbi historikun, kontributin dhe profesionalizmin e konsoliduar gjatë dekadave në ofrimin e shërbimeve meteorologjike dhe mbështetjes strategjike. Ai gjithashtu shërben si një pikë referimi për të afirmuar angazhimin e vazhdueshëm drejt modernizimit, forcimit të kapaciteteve dhe përputhjes me standardet ndërkombëtare.

Si do ta përshkruanit kontributin e këtij institucioni në një fjali?

Ky institucion shërben si kompas i saktë i motit dhe i vendimmarrjes, duke udhëhequr me profesionalizëm dhe gatishmëri, dhe duke transformuar çdo të dhënë meteorologjike në veprim strategjik që mbron jetën, asetet dhe operacionet kombëtare.

Çfarë mesazhi keni për brezat e rinj që duan të ndjekin këtë profesion?

Brezat e rinj duhet të angazhohen me pasion dhe disiplinë në studimin e meteorologjisë dhe shkencave të lidhura, duke zhvilluar aftësi analitike, teknologjike dhe operative për t’u bërë profesionistë të besueshëm dhe inovativë në këtë fushë. *Le të ndjekin kuriozitetin e tyre për qiellin dhe motin, duke e shndërruar pasionin për atmosferën në një mision të jashtëzakonshëm për të kuptuar dhe shërbyer në botën që na rrethon.*

Si nderohen dhe kujtohen pionierët e këtij shërbimi?

Pionierët e këtij shërbimi nderohen dhe kujtohen përmes përvjetorëve, ceremonive dhe aktiviteteve institucionale, që vlerësojnë kontributin e tyre të pazëvendësueshëm në ngritjen dhe konsolidimin e meteorologjisë ushtarake. Trashëgimia e tyre shërben si frymëzim dhe udhërrëfyes për brezat e rinj, duke theksuar fisnikërinë, profesionalizmin dhe përkushtimin ndaj misionit kombëtar.

Cilat janë vlerat që e kanë mbajtur këtë institucion të fortë ndër vite?

Institucioni është mbajtur i fort ndër vite përmes angazhimit të palëkundur ndaj saktësisë dhe besueshmërisë, profesionalizmit në çdo nivel dhe përkushtimit ndaj misionit kombëtar. Vlerat e integritetit, disiplinës dhe bashkëpunimit kanë krijuar një trashëgimi të konsoliduar, që udhëheq çdo gjeneratë drejt standardeve më të larta. Këto parime e bëjnë shërbimin një institucion të qëndrueshëm, inovativ dhe të gatshëm për çdo sfidë.

“MOS I QUANI ‘THJESHT TOKË’ VENDET KU SHKELNI”

Toka, lufta, emigrimi dhe dhimbja e përkatësisë në kohën tonë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Atdheu nuk është një fjalë, është ndjenjë

Ka fjalë që i përdorim çdo ditë, por që rrallë i ndjejmë deri në fund: “Tokë”, “Atdhe”, “Vend”. I themi lehtë, i kalojmë nëpër buzë pa u ndalur, pa e kuptuar peshën që mbajnë.

Por në të vërtetë, toka nuk është thjesht një sipërfaqe. Ajo është kujtesë, është histori, është gjak dhe sakrificë. Është vendi ku fillon gjithçka për ne si individë dhe si komb.

Atdheu nuk është vetëm një koordinatë në hartë. Ai është pjesë e identitetit tonë. Është vendi ku kemi hedhur hapat e parë, ku kemi dëgjuar fjalët e para, ku kemi ndjerë për herë të parë se i përkasim dikujt, diku.

Dhe pikërisht për këtë arsye, nuk mund ta quajmë thjesht tokë vendin ku shkelim.

Toka si trashëgimi: Ajo që na është dhënë dhe që duhet ta ruajmë

Çdo pëllëmbë toke ka një histori që nuk shkruhet gjithmonë në libra. Ajo jeton në kujtesën e njerëzve, në rrëfimet e të moshuarve, në heshtjen e varreve.

Kjo tokë nuk është krijuar nga ne. Ajo na është dhënë. Është trashëguar brez pas brezi, shpesh e mbrojtur me çmimin më të lartë: jetën.

Kur ecim mbi të, ecim mbi sakrificë. Kur jetojmë mbi të, jetojmë mbi mundin dhe djersën e atyre që erdhën para nesh.

Dhe kjo e bën atë të shtrenjtë. Jo në kuptimin material, por në atë shpirtëror. Sepse nuk ka çmim për atë që përfaqëson.

Lufta: Kur toka mbrohet me jetë

Ka momente në histori kur toka nuk është më vetëm vend për të jetuar, por arsye për të luftuar.

Në ato çaste, njeriu përballet me zgjedhjen më të vështirë, të dorëzohet apo të mbrojë atë që është e tij. Dhe shumë herë, zgjedhja ka qenë sakrificë.

Ushtari nuk lufton për një copë dhe. Ai lufton për familjen, për historinë, për dinjitetin. Ai lufton që ajo tokë të vazhdojë të jetë shtëpi për të tjerët.

Dhe në këtë kuptim, toka merr një dimension të shenjtë. Ajo nuk është më vetëm vend, është amanet.

Emigrimi: Dhimbja e largimit nga rrënjët

Por jo gjithmonë njeriu ka mundësinë ta mbrojë ose ta jetojë tokën e tij. Ka raste kur rrethanat e detyrojnë të largohet.

Emigrimi nuk është vetëm një udhëtim. Është një ndarje. Një këputje e brendshme që nuk shërohet lehtë.

Ai që largohet, merr me vete kujtimet, por lë pas një pjesë të shpirtit. Sepse toka nuk është diçka që mund ta marrësh me vete. Ajo mbetet aty.

Dhe në vend të huaj, çdo gjë mund të jetë më e mirë, më e bukur, më e zhvilluar – por kurrë nuk është e jotja në të njëjtën mënyrë.



Përbuzja: Kur nuk dimë çfarë kemi

Ka diçka edhe më të dhimbshme se humbja e tokës, përbuzja e saj.

Kur dikush e përbuz vendin tënd, ndjen një plagë të thellë. Është sikur të përbuzet një pjesë e jotja. Sepse atdheu nuk është i ndarë nga identiteti yt.

Por ndonjëherë, përbuzja vjen nga brenda. Nga vetë ne.

E themi shpesh: “ky vend nuk bëhet”, “këtu nuk ka shpresë”. Dhe pa e kuptuar, fillojmë ta shohim tokën tonë me sy mosbesimi, me zhgënjim, me largësi.

Kjo është një humbje e heshtur, por shumë e rrezikshme.

Ndjenja e fajit dhe humbjes

Kur largohemi dhe fillojmë ta shohim vendin tonë me përbuzje, lind një ndjenjë e brendshme që rrallë e pranojmë: faji.

Faji që u larguam. Faji që nuk bëmë mjaftueshëm. Faji që ndoshta nuk e deshëm sa duhet. Dhe kjo ndjenjë na ndjek, edhe nëse nuk e themi me zë të lartë.

Sepse në thellësi, e dimë që toka nuk ishte vetëm një vend, ishte pjesë e jona.

Rikthimi i ndërgjegjes: Të duash pa kushte

Megjithatë, ka gjithmonë një mundësi për reflektim.

Të duash atdheun nuk do të thotë ta idealizosh. Do të thotë ta pranosh ashtu siç është – me të mirat dhe të metat e tij.

Do të thotë të mos e përbuzësh, edhe kur të zhgënjën. Do të thotë të mos e harrosh, edhe kur je larg. Do të thotë të ndihesh pjesë e tij, edhe kur nuk je fizikisht aty.

Sepse lidhja me tokën nuk është vetëm fizike – është shpirtërore.

Një mesazh që duhet ndjerë

Mos e quani thjesht tokë, vendet ku shkelni. Sepse ajo tokë ka parë histori që ju nuk i dini. Ka mbajtur njerëz që nuk jetojnë më. Ka përballuar kohë që ju nuk i keni përjetuar. Dhe mbi të gjitha ajo ju mban ju sot.

Respektojeni.

Ndjejeni.

Mos e përbuzni.

Sepse mund të vijë një ditë kur do ta kërkonin dhe nuk do ta keni. Dhe atëherë do ta kuptoni sa e shtrenjtë ishte. Sepse në fund... toka nuk është thjesht tokë.

Është kujtesë. Është sakrificë. Është identitet. Është... **Atdheu.**

Një rezultat që flet më shumë se statistikak

Në një kohë kur sfidat globale të sigurisë po bëhen gjithnjë e më komplekse, një sondazh i fundit i publikuar nga Instituti Amerikan “Foreign Policy Research” sjell një lajm domethënës për Shqipërinë: 69 për qind e qytetarëve shqiptarë shprehen të gatshëm të luftojnë për vendin e tyre.

Ky rezultat e rendit Shqipërinë në vendin e dytë mes vendeve anëtare të NATO-s, menjëherë pas Turqisë dhe përpara një sërë shtetesh të zhvilluara europiane si Suedia, Finlanda apo Norvegjia. Përtej shifrave, ky tregues është një dëshmi e fortë e lidhjes së thellë që shqiptarët kanë me atdheun, si dhe e besimit në institucionet e sigurisë, në veçanti në Forcat e Armatosura.

Ky nuk është thjesht një rezultat sondazhi. Është një histori suksesi.

Shqipëria në hartën e gatishmërisë së NATO-s

Sipas të dhënave të sondazhit:

- Shqipëria renditet me 69% gatishmëri për të luftuar
- Turqia kryeson me 88%
- Suedia (66%), Finlanda (64%) dhe Mali i Zi (63%) ndjekin më pas
- Ndërsa vende si Gjermania, Italia apo Holanda paraqesin nivele dukshëm më të ulëta

Ky kontrast ngre një pyetje të rëndësishme: pse një vend i vogël si Shqipëria shfaq një nivel kaq të lartë angazhimi qytetar?

Përgjigjja gjendet në histori, në kulturë dhe në mënyrën si është ndërtuar identiteti kombëtar.

Rrënjët historike të një gatishmërie të lartë

Shqipëria është një vend me një histori të gjatë rezistence. Nga luftërat për pavarësi, te qëndresa ndaj pushtimeve dhe deri te periudhat e vështira të tranzicionit, shqiptarët kanë treguar vazhdimisht një ndjenjë të fortë mbrojtjeje ndaj territorit dhe identitetit të tyre.

Kjo trashëgimi historike nuk është zhdukur. Ajo është transmetuar brez pas brezi, duke ndërtuar një kulturë ku mbrojtja e vendit nuk shihet thjesht si detyrë ushtarake, por si përgjegjësi qytetare.

Forcat e Armatosura, një faktor kyç besimi

Një nga elementët më të rëndësishëm që ndikon në këtë gatishmëri është roli i Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Në vitet e fundit, FA-të kanë kaluar një proces të thellë modernizimi dhe profesionalizimi:

- Integrimi i plotë në strukturat e NATO-s
- Pjesëmarrja në misione ndërkombëtare paqeruajtëse
- Trajnime të avancuara dhe standarde të larta operacionale
- Investime në pajisje dhe kapacitete mbrojtëse

Ky transformim ka rritur ndjeshëm besimin e qytetarëve. Sot, Forcat e Armatosura nuk perceptohen vetëm si një strukturë mbrojtëse, por si një institucion modern, i aftë dhe i besueshëm.

Kontributi ndërkombëtar, një histori suksesi shqiptare

Shqipëria ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në misionet e NATO-s dhe operacionet ndërkombëtare në:

- Afganistan
- Kosovë
- Bosnje dhe Hercegovinë
- Misione të tjera paqeruajtëse

Ushtarakët shqiptarë janë vlerësuar për profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin e tyre. Ky angazhim jo vetëm



Nga historia, sot: Shqipëria, një model gatishmërie në Aleancën e NATO-s

që ka forcuar pozitën e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, por ka ndikuar edhe në rritjen e krenarisë kombëtare brenda vendit.

Ky është një element kyç që shpjegon pse qytetarët ndihen më të lidhur dhe më të gatshëm për të mbrojtur vendin e tyre.

Krahasimi me vendet e tjera, një realitet i ndryshëm

- Historia e afërt me konfliktet është ende e freskët
- Ndjenja e identitetit kombëtar është më e fortë
- Solidariteti shoqëror është më i theksuar

Këto elemente krijojnë një terren ku gatishmëria për mbrojtje është më e lartë.

Roli i brezit të ri, një kapital për të ardhmen

Një aspekt pozitiv i këtij sondazhi është përfshirja e brezit të ri. Të rinjtë shqiptarë, pavarësisht sfidave sociale dhe ekonomike, vazhdojnë të shprehin një ndjenjë të fortë përkatësie. Programet e edukimit, bashkëpunimi me NATO-n dhe promovimi i vlerave të sigurisë kombëtare kanë ndikuar në formimin e një brezi më të ndërgjegjshëm dhe më të përgatitur.

Sfida dhe përgjegjësi për të ardhmen

Megjithatë, ky rezultat nuk duhet parë si arsye për

vetëkënaqësi. Ai sjell edhe përgjegjësi:

- Për të vazhduar investimet në mbrojtje;
- Për të forcuar më tej kapacitetet e FA-ve;
- Për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi sigurinë;
- Për të mbajtur të lartë besimin qytetar.

Sepse gatishmëria nuk është vetëm deklaratë. Ajo duhet të mbështetet nga struktura të forta dhe politika të qëndrueshme.

Krenari dhe detyrim

Rezultati i këtij sondazhi është një arsye për krenari kombëtare. Ai tregon se shqiptarët janë të gatshëm të mbrojnë vendin e tyre, vlerat e tyre dhe të ardhmen e tyre.

Por njëkohësisht, është edhe një thirrje për përgjegjësi. Forcat e Armatosura mbeten shtylla kryesore e sigurisë kombëtare, por mbrojtja e vendit është një detyrë që i përket të gjithëve.

Shqipëria që beson dhe mbron

Në një botë të pasigurt, Shqipëria shfaqet si një vend me një kapital të fortë njerëzor: gatishmërinë për të qëndruar dhe për të mbrojtur. Ky është një tregues i qartë se përtej sfidave, ekziston një lidhje e fortë mes qytetarëve dhe atdheut.

Dhe kjo është ndoshta forca më e madhe që një vend mund të ketë.

Sepse një komb që është i gatshëm të mbrojë veten, është një komb që beson në të ardhmen e tij.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

(Në kuadrin e 145-vjetorit të lindjes)

Fëmijëria dhe shkollimi

Tol Arapi ka lindur në mars të vitin 1881, në Vlorë. Babai, Stavre Arapi u martua me Asprian nga fisi i Jankajve të Myzeqesë së Vlorës, nga Poro. Nëna ishte një grua e gjatë, e bukur dhe shumë e zgjuar, ndërsa babai ishte i shkurtër, zeshkan, shumë trim, një gjahtar i fortë. Ai ishte i vetmi i krishterë që mbante armë në Vlorë, i cili kishte një pushkë të gjatë “Kapsolli”, si dhe mbante pishqollë në brez. Prindërit, Tol Arapin e çuan në shkollë në moshën 5 vjeç, edhe pse ishin të varfër dhe u kishin vdekur disa fëmijë. Shkolla bëhej për të krishterët në gjuhën greke, për myslimanët në gjuhën turke. Qeveria turke nuk lejonte shkolla në gjuhën shqipe. Toli mbaroi dhe të tretën (unike) qytetëse, e kur mbaronte viti shkollor, për t’u “përmbledhur” prindërit i fushnin fëmijët në zanate. Ai mësoi për samarxhi tek Josif Marjanku nga Marjani i Korçës. Usta Josifi e donte shumë dhe në behar e mori në fshat bashkë me djemtë e tij. Kishte shumë dëshirë të shkonte në Korçë, sepse thuhej se në malet e Korçës ishte një hajdut, Shahin Matraku dhe usta Josifi kishte miqësi me të. Në vitin 1896 shkoi në Stamboll për studime dhe punë.

Në lëvizjen patriotike dhe me çetat në male

Në vitin 1906 u largua nga Stambollit dhe shkoi në Selanik. Në Maqedoni kishte një lëvizje dhe Tol Arapi mendoi të merrte pjesë në kryengritje, por në Selanik pendohet dhe kthehet përsëri në Stamboll. Më 1907 u kthye përsëri në Shqipëri. Midis patriotëve që punonin për çlirimin kombëtar në Vlorë takohet me Mullah Xhaferr Drashovicën, Kristo Karbunarën, Kol Karbunarën, Hamit Lumi, Dush Strati, Hamza Isaj, Musa Çakërrri, Osmën Shehu, Latif Pasho, Imer Radhimën etj. Këta patriotë kishin formuar në Vlorë bërthamën e një komiteti kryengritës të fshehtë, i cili punonte për zgjimin e mëtejshëm të popullit shqiptar dhe për luftën që i duhej bërë robërisë turke. Ky komitet ishte i lidhur me kolonitë kombëtare dhe kishte gjetur mënyra të volitshme për të prurë në Vlorë botime të shkrimtarëve të Rilindjes dhe sidomos veprat e Naim Frashërit, përkthimet e Kostandin Kristoforidhit dhe ndonjë gazetë që botohej në gjuhën shqipe në Bukuresht, në Sofje e në ndonjë tjetër koloni kombëtare. Tol Arapi lexon shkrimet e rilindësve dhe u bë një nxënës i flaktë i tyre. Në fund të vitit 1907 kthehet në Stamboll. Në Vlorë (1908) ishte themeluar Klubi “Labëria”, anëtar i të cilit u bë dhe Tol Arapi. Klubi punoi gjer më 1911. Formalisht ai ishte një klub kulturor, ku mblidheshin e bisedonin dhe jepej mësim në gjuhë shqipe. Në të vërtetë, klubi bënte propaganda për kryengritje kundër Turqisë. Në Stamboll ishte formuar klubi shqiptar “Bashkimi”, kryetar i të cilit ishte kosovari patriot Nexhip Bej Draga. Në klubin shqiptar “Bashkimi” të Stambollit, 1908, bënë pjesë: Bajo Topulli, Dervish Hima, Mehmet Pavari, Nexhip Draga, Stavre Karoli, Tol Arapi, Vasil Vreto etj. Në klub mblidheshin shqiptarët dhe bisedonin për çështjet e Shqipërisë. Më 1909 në klub erdhën dhe përfaqësues të kolonisë shqiptare nga Rumania. Revolucion i xhonturqve e gjeti në Stamboll. Në klub mësuan se nga Shqipëria ishin zgjedhur deputet për në parlamentin turk Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina.

Më 1909, në Qishë-Bardhë u mblodh komisioni i Kazasë së Vlorës. Tol Arapi bënte pjesë në çetën që ruante Komisionin. Këtu ishin Namik Selimi me çetën e tij, Abas Nuri e Elmaz Xhaferri nga Kanina, Alem Mehmeti nga Tragjasi, Ali Beqiri nga Velça, Shero Emini nga Smokthina, Jakup Agalliu nga Vlorë etj. Komisioni vendosi t’u kërkojë Fuqive të Mëdha autonominë e Shqipërisë. Komisioni caktoi si delegat Mahmut Qemalin, të birin e Ismail Qemalit dhe Ali Durmishin nga Karbunara. Xhonturqit nuk i mbajtën premtimet e veta, në mënyrë demonstrative dhe për të rrëmbyer armë nga turqit, filluan të formojnë çeta. Kur u formua çeta që udhëhiqej nga Namik Selimi, Toli Arapi dhe Hamza Isaj shkuan në çetë. Çeta u nda në dy pjesë: Toli Arapi bënte pjesë në çetën që komandonte Zaçe Xhelua nga katundi Smokthine - Mesaplik. Ishin gjithsej 25 veta, pjesa më e madhe fshatare. Bukën e siguronin nga fshatrat dhe në stanet e Shashicës. Në kohën që ishin në çetë dhe shkonin në fshatra, Tol Arapi u këndonte fshatarëve libra shqip dhe sidomos “Bagëtinë e Bujqësinë” e Naim Frashërit.

Në Luftën e Janinës dhe në shërbim të shtetit shqiptar

Në vjeshtën e vitit 1912 nisi Lufta Ballkanike. Turqia po mobilizonte ushtarë dhe i dërgonte në Janinë. U nisën në Janinë që të mbronin Shqipërinë nga grekët. Mendonin se flamuri do ngrihej në Janinë që ishte një nga vilajetet, për të shpëtuar dhe Çamërinë. Ishte e para herë që Turqia merrte të krishterët ushtarë. Më përpara “kaurët” paguanin “nizam”, taksë për mos shkuarje ushtar. Kësaj radhe i merrte ushtarë, por nuk u jepte armë, i përdorte për ndihmë “hyzmete”. Nga

NJË JETË PËR ATDHEUN: Rrugëtimi i Tol Arapit, saga e një patrioti shqiptar



të gjithë të tjerët Tol Arapi u pajis me armë. Në Janinë punonte klubi i shqiptareve, i cili ishte hapur dhe mbahej prej Hoxha Kadriut. Atje takoheshim e bisedonim për ngritjen e flamurit në Janinë. Në dhjetor të 1912, kur luftonim në Janinë, Muhametit i erdhi një letër nga i vëllai, Hamza Isaj, i cili i thoshte: “Braktisni ushtrinë turke dhe ejani në Vlorë, se këtu ne e ngritëm flamurin kombëtar. Shqiptarët të mos vriten për Turqi”. Vlonjatët i thërriste Ismail Qemali. Qeveria e Vlorës, Tol Arapin e emëroi nënkomisar të Policisë botore. Në polici u morën me mbajtjen e qetësisë. Ruanin dhe pazarin, ku mbanim qetësi me ndihmën e xhandarmërisë së vogël, sa për qytetin e Vlorës. Policia brenda një kohe të shkurtër mundi të vendosë rregull në Vlorë dhe ishte në dijeni për të gjithë elementët e dyshimtë që futeshin në qytet. Erdhi dhe Tomsoni në Vlorë, i cili u mor me organizimin e xhandarmërisë, por bashkëpunonte me ne. Tomsoni i nxori në punë të burgosurit. Me punën e të burgosurve u nxorën gurët e Kalasë dhe u shtrua rruga e Skelës, e cila ishte rrugë e ngushtë. Kur tradhtia e Esatit u bë e hapur, Tol Arapi botoi “Kuçedrën” më 15 qershor 1914. Botimi i broshurës bëri përshtypje të madhe, sepse Esati në atë kohë ishte në fuqi, ai ishte fuqiplotë në Durrës. 300 copë të “Kuçedrës” i dërgoi në Kolonitë Shqiptare të Amerikës. Ndërkohë fillon kryengritja e rebelëve dhe Tol Arapi prej Vlorë shkoi në Durrës. Pozicioni ishte te Ura e Dajlanit. Këtu ishte një pjesë, ndërsa pjesa tjetër mbrohej më përpara, rrugës që shkon për në Shijak. Rebelët dilnin nga Kodrat e Shënavlashit. Aty ka pa Tomsonin që me kobure në dorë thërriste: - Burra djem “Për mbret!”, “Për atdhe!”. Ai fliste shqip. Përpjekja ishte shumë e ashpër, e rreptë. Rebelët fituan. Ata erdhën dhe në Vlorë, ku ulën flamurin shqiptar dhe ngritën atë turk. Të gjithë patriotët vlonjatë u arratisën. Tol Arapi, Hamza Isaj, Ymer Radhima, Mustafa Tragjasi shkuan në Itali, në Bari. Atje qëndruan rreth dy muaj. Kur erdhën në Vlorë çdo gjë ishte e qetë, rebelët kishin ikur. Gjendja ishte e turbullt dhe Tol Arapi shkoi në polici. Më 1914 Italia zbarkon në Vlorë.

Lufta e Vlorës 1920

Zbarkimi i Italisë më 1914 e gjeti në Vlorë. Punonte këpucar në dyqanin e Vaskut. Kur mbaroi Lufta e Parë Botërore, Italisë i ishte dhënë nga Fuqitë e Mëdha e drejta të mbante hinterlan-

din e Vlorës. Vlorë rrezikohej të mbetej nën pushtimin italian. Kur filloi Kongresi i Lushnjës, Tol Arapi iu besua shpurja e postës nga Vlorë në Lushnjë, në kongres. Posta i dorëzohej në kafenenë e Hamza Isait. Përveç në Kongresin e Lushnjës, postën e ka shpurë dhe në Shkodër në Komisionin Anglez. Postën e fshinte në samar të kalit. Kongresi i Lushnjës vazhonte punimet, ndërsa në Vlorë nisi të përhapet ideja e një kryengritjeje kundër italianëve. Filluan të dërgohen njerëz në katunde për të përgatitur kryengritjen. Mbledhja e delegatëve ishte caktuar për në Barçalla (Dukat). Tol Arapi gjendej në Vlorë dhe një ditë përpara se të fillonte sulmi mbi italianët, mori një letër nga Hamza Isai, i cili shkruante “urgjentisht të takohemi në Beun”. U nis bashkë me Isa Çakërrin. Shkuan nëpër Drashovicë dhe në kohë darke mbërritën në Beun. Komisioni që drejtonte çetat, pas Beunit u vendos në Drashovicë dhe një pjesë e komandës ushtarake në Lllakatund, e cila udhëhiqej nga Ahmet Lepenica. Ndërsa vazhdonin luftimet, Toli Arapi u caktua në zonën e Myzeqesë: Zhukë, Poro, Novoselë dhe Mifol nga komisioni i çetave për të mbledhur bagëti e bukë për luftëtarët.

Përsëri në ndërtimin e shtetit shqiptar

Mbas 1920 filloi organizimi i Policisë. Hamza Isai u emërua drejtor, Tol Arapi komisar. U ngarkua nga Prefektura për të organizuar Policinë e Himarës. Shkoi bashkë me Hasan Pulon dhe Azis Çamin, ushtarak dhe ndenjën katër muaj. Në vitin 1922 e transferuan komisar në Tiranë, por dha dorëheqjen sepse përpiqej për shqiptarizmin e Kishës Ortodokse të qytetit të Vlorës. Në vitin 1922 u bë Kongresi Kishtar i Beratit, i cili themeloi Kishën Shqiptare Autoqefale. Po në këtë vit në Korçë, u dorëzua dhespot imzot

Fan Noli. Më 4 dhjetor kisha e madhe e Shën - Gjergjit u mbush me mizëri njerëzish, si qeveritarë edhe populli dhe me një ceremoni të shkëlqyer u dorëzua Hirësia e Tij imzot Theofan Noli, Mitropolit i Durrësit. Gëzimi i bashkuar me mallëngjim ishte i papërshkrueshëm, se atë që dëshironin me gjithë shpirt, iu realizua. Lufta për shkëputjen e Kishës Autoqefale bëhej në një kohë, kur zhvillohej edhe lufta për reforma shoqërore në Shqipëri. Vrasja e Avni Rustemit ishte një ngjarje që e tronditi Vlorën. Tol Arapi vendosi kurorën e Këshillit të lartë Këshilltar mbi varrin e Avniut. Qazim Kokoshi si kryetar i bashkisë së Vlorës, u interesua dhe e mori Komisar të Bashkisë, mbasi dëshironte ta organizonte mirë policinë e Bashkisë. Më 1925 erdhi Zogu në Shqipëri. Fan Noli me Qazim Kokoshin u arratisën. Tol mbeti në detyrë. Kryetari i Bashkisë Nuredin Vlorë, duke parë se Tol Arapi punonte mirë, e përkrahu dhe nga bashkëpunimi i ngushtë filloi të çmojë punën.

Nga gjyqi politik në burg të Burrelit

Më 1926 qeveria e Zogut, erdhi në marrëveshje me qeverinë greke për njohjen e kishës shqiptare. Ahere erdhi prej Athine episkop Hrisanthos në Tiranë. Në telegramin për at Vasil Markos, Tol Arapi i thoshte që të ruhet nga dhëlpëritë fanariote, Statuti i kongresit të Beratit të mos prekej, kisha shqiptare të mos lejojë privilegie dhe ndërhyrje. E arrestuan dhe e burgosën për një javë në Polici të Vlorës dhe më pas në burgun e Tiranës. E akuzonin se donte të “çartte” miqësinë greko-shqiptare. Iu bë gjyqi politik. Doli i pafajshëm dhe u kthye përsëri në detyrë si Komisar i Bashkisë. Tol Arapi iu bashkua lëvizjes unite, d.m.th të bashkimit të Kishës Ortodokse me Kishën Katolike. Ai dhe të tjerët ortodoksë vlonjatë u bashkuan me bashkatdhetarët, Arbëreshët e Italisë, që ruajnë edhe sot e kësaj dite fenë e Skënderbeut, d.m.th ritin ortodoks, por lidhur me Papën e Romës dhe jo me Patrikanën Greke.

Doli në pension kur ishte kryetar bashkie Ali Asllani në vitin 1938. Familja e Tol Arapit u përfshi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Shtëpia e tij u kthye në një nga bazat e qytetit të Vlorës. Në dhjetor të vitit 1942 i dogjën shtëpinë dhe e arrestojnë duke e futur në burg së bashku me 40 e ca vlonjatë. E internuan në Gërmen, Burrel. Vdiq më 25 dhjetor 1962 dhe u varros në Zvërnec.



KTHESA HISTORIKE: RRUGËTIMI I KOSOVËS DREJT SHTETFORMIMIT

Ndërhyrja ushtarake e NATO më 24 mars 1999 përbën një nga momentet më të rëndësishme në historinë moderne të Ballkanit dhe një pikë kthese vendimtare në procesin e shtetformimit të Kosovës. Ky operacion 78-ditor nuk ishte thjesht një aksion ushtarak, por një ndërhyrje me pasoja të thella politike, strategjike dhe historike, që ndryshoi rrjedhën e zhvillimeve në rajon dhe hapi rrugën për lindjen e një realiteti të ri shtetëror.

Konteksti historik dhe ndërhyrja ndërkombëtare
Në fund të viteve '90, Kosova ishte kthyer në një zonë krize të thellë humanitare dhe sigurie, si rezultat i politikave represive të regjimit serb ndaj popullsisë shqiptare. Spastrimi etnik, dhuna sistematike dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut krijuan një situatë që tejkaloi kufijtë e një konflikti të brendshëm, duke u shndërruar në një çështje ndërkombëtare sigurie.

Në këtë kontekst, ndërhyrja e NATO-s u justifikua si një domosdoshmëri për të parandaluar një katastrofë humanitare dhe për të rikthyer stabilitetin në rajon. Për herë të parë në historinë e saj, NATO ndërhyri pa një mandat të drejtpërdrejtë nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, duke vendosur një precedent të ri në doktrinën e ndërhyrjeve humanitare.

Operacioni ajror i NATO-s, i cili zgjati 78 ditë, goditi objektiva strategjike ushtarake dhe infrastrukturore të forcave serbe, duke detyruar regjimin e Beogradit të tërhiqej nga Kosova. Kjo ndërhyrje përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës më 9 qershor 1999, e cila parashikonte tërheqjen e forcave serbe dhe vendosjen e një pranie ndërkombëtare paqeruajtëse në territorin e Kosovës.

Pasojat ushtarake dhe strategjike
Nga pikëpamja ushtarake, ndërhyrja e NATO-s tregoi epërsinë e fuqisë ajrore dhe rëndësinë e koordinimit ndërkombëtar në operacionet moderne. Ajo gjithashtu dëshmoi se konfliktet rajonale mund të kenë implikime globale dhe se siguria kolektive mbetet një parim kyç në arkitekturën ndërkombëtare.

Vendosja e forcave të KFOR-it në Kosovë më 12 qershor 1999 shënoi fillimin e një faze të re stabilizimi dhe sigurie. Këto forca luajtën një rol thelbësor në garantimin e rendit, në kthimin e refugjatëve dhe në krijimin e kushteve për ndërtimin

e institucioneve demokratike.

Dimensioni historik dhe kulturor
Përtej aspektit ushtarak dhe politik, lufta në Kosovë la pasojë të thella në trashëgiminë historike dhe kulturore. Shkatërrimi i objekteve me rëndësi historike, si Çarshia e Gjakovës dhe kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, përbën një humbje të madhe për identitetin kombëtar shqiptar.

Këto monumente nuk janë vetëm objekte fizike, por bartës të kujtesës historike dhe simbolikës kombëtare. Dëmtimi i tyre synonte jo vetëm shkatërrimin material, por edhe cenimin e identitetit dhe trashëgimisë kulturore të një populli.

Megjithatë, procesi i rindërtimit dhe restaurimit të tyre pas luftës dëshmon për qëndrueshmërinë dhe vullnetin e shoqërisë kosovare për të ruajtur dhe forcuar identitetin e saj historik.



Rruga drejt pavarësisë
Ngjarjet e vitit 1999 krijuan bazën për zhvillimet e mëvonshme politike që kulmuan me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Kjo shpallje nuk ishte një akt i izoluar, por rezultat i një procesi të gjatë ndërkombëtar dhe institucional, i mbështetur nga prania e misioneve ndërkombëtare dhe ndërtimi gradual i institucioneve vendore.

Pavarësia e Kosovës përfaqëson një nga rastet më të veçanta në të drejtën ndërkombëtare, duke reflektuar një kombinim të faktorëve historikë, politikë dhe humanitarë. Ajo u njoh nga një numër i madh shtetesh dhe u mbështet nga vendet kryesore perëndimore, duke konsoliduar pozitën ndërkombëtare të Kosovës.

Shtetndërtimi dhe sfidat aktuale
Sot, Republika e Kosovës është në një fazë të avancuar të konsolidimit institucional. Ajo ka ndërtuar strukturat themelore të një shteti demokratik, duke përfshirë institucionet e sigurisë, drejtësisë dhe administratës publike.

Megjithatë, sfidat mbeten të shumta. Integrimi në strukturat euroatlantike, veçanërisht në Bashkimin Evropian dhe NATO, kërkon përmbytjen e standardeve të larta politike, ekonomike dhe ligjore. Dialogu me Serbinë, forcimi i shtetit ligjor dhe zhvillimi ekonomik janë ndër prioritetet kryesore të shtetit të Kosovës.

Në këtë kontekst, trashëgimia e ndërhyrjes së NATO-s dhe e luftës për liri mbetet një element i rëndësishëm i identitetit shtetëror dhe i orientimit strategjik të Kosovës.

Ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 përbën një moment historik që ndryshoi jo vetëm fatin e Kosovës, por edhe dinamikat e sigurisë ndërkombëtare. Ajo shënoi fundin e një periudhe të errët dhune dhe hapi rrugën për ndërtimin e një shteti të ri.

Rrugëtimi i Kosovës drejt shtetformimit është një histori e rezistencës, sakrificës dhe përkushtimit ndaj lirisë dhe demokracisë. Sot, ndërsa Kosova vijon rrugën e saj drejt integritetit euroatlantik, kujtesa e këtyre ngjarjeve mbetet një burim frymëzimi dhe një kujtesë e rëndësishme për përgjegjësinë që sjell liria. Ky proces nuk është vetëm një kapitull i historisë shqiptare, por edhe një dëshmi e rolit që bashkësia ndërkombëtare mund të luajë në mbrojtjen e vlerave universale dhe në ndërtimin e paqes së qëndrueshme.



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Në kujtim të përjetshëm: Kapiten Harun Akshit dhe miqësia që nuk vdes kurrë

Në përkujtim të shokut tonë ish-student të Akademisë së Luftës Tokësore në Stamboll, Dëshmorit Şehit Jandarma Pilot Kurmay Yüzbaşı / kapiten Harun Akshit lindur më 5.8.1967 në Denizli të Republikës së Turqisë dhe rënë më 15.9.1999 gjatë një misioni stërvitor me helikopter në rajonin Siirt / Pervari / Köprüçay Turqi, si dhe u martirizua më 30.1.2000, duke ngelur përjetësisht në kujtesën e shokëve të grupit tonë mësimit si dhe në kujtesën e nderimit të kombit turk.

Ishin ditë plot vapë në Tiranë të një gushti të përzhitur, në një vit të trazuar të 1997-ës. Në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, kishte ardhur një bursë për studime në Akademinë e Luftës Tokësore në Stamboll të Republikës së Turqisë. Personeli njoftoi kriteret dhe rezultova fitues si ish-pedagog në këtë Akademi, ku isha emëruar më 22 gusht 1997. Muajt shtator e tetor kaluan shpejt edhe pse strukturat e mbrojtjes përgatitën një kontingjent të gjerë prej 27 studentësh ushtarakë për shumë shkolla kurse e specializime me periudha të ndryshme, bazuar kjo në një marrëveshje të gjerë shqiptaro-turke të vitit 1992. Nga gradat e larta ishin përzgjedhur nënkolonel Zaho Golemi dhe nënkolonel Sokol Ngjeçi në Akademinë e Luftës Tokësore, kolonel Vait Golikja në Akademinë e Forcave të Armatosura, nënkolonel Fatmir Zyfi në Akademinë e Luftës Ajrore, si dhe mjaft të tjerë nga gjithë strukturat, armët e shërbimet e FARSH-së. Rrugëtimi ynë drejt Stambollit do të ishte me autobus në linjën Tiranë-Qafë Thanë-Maqedoni, Bullgari-Turqi. Përfunduar në kazermën ushtarake “General Kenan Evren këshillasënda”, kazermë që mbante emrin e një shqiptari, në Stambollin anadollian, ku ishte vendosur edhe shkolla “Lisan Okullu”/shkolla e gjuhës. Mbërritëm në mesditë të ditës së hënë, më datën 3 nëntor 1997, ndërsa kolegët tanë kishin dy javë që kishin nisur studimet. Me sforcë arritëm studentët e tjerë në mësim në gjuhën turke për një vit. Pas përfundimit me sukses të shkollës së gjuhës turke dhe diplomimit, 1 tetori i vitit 1998 na gjeti në auditorët e Akademisë së Luftës Tokësore në Lagjen “Yeni Levent” të Stambollit Evropian. Në këtë shkollë do të studionim për dy vite, ku edhe u njohëm me miq e shokë të shumtë nga Turqia por edhe nga vende të tjera si nga SHBA, Franca, Gjermania, Azerbajxhani, Bosnja, Maqedonia, Egjipti, Koreano Jugor, Bangladeshas, Pakistanëzë... etj. Por natyrisht edhe me studentë vendas nga Turqia e Qiproja Turke. Fakt është se që të gjithë ofronin miqësi e dashamirësi, mikpritje ndaj nesh që ishim miq në Stamboll, por njeri prej studentëve dallonte për miqësinë që ofronte, për dashamirësinë ndaj nesh dhe për më tepër ishte edhe “rehberi” për mua në vitin e parë të studimeve. Harun Akshit ishte më shumë se një shok e mik i mirë. I rritur me edukatë e kulturë që dallonte në shokët e grupit tonë. Ai ishte me origjinë nga Dinizli, por që sakrifikonte për mirësinë e të huajve, një shpirt njeriu që studentët e ardhur në Stamboll për studime nuk i shikonte kurrë si “të huaj”, por si pjesë të trupëzuar në studime si të barabartë mes të barabartëve, vihej në dispozicionin tonë, edhe duke sakrifikuar detyrimet e tij. Kishte një karakter kaq të hapur dhe tejet miqësor, na merrte në shtëpi, na vinte pasdite, ora e takimit për çaj ishte ora e miqësisë ndërmjet popujve, para mësimit e stërvitjeve, në auditor e kudo ishte me ne. Kishte një vështrim mjaft miqësor, gjithmonë zemërhapur dhe i qeshnin sytë dhe zemra, vështrim që depëronte në shqetësime, që ne të ndjeheshim rehat si në shtëpinë tonë. Në festa e gëzime ishte prezent, ofronte shpirt e zemërbardhësi. Çfarë ishte e tij ishte edhe e jona, i gatshtëm për mbështetje ditën dhe natën. Prandaj edhe kanë ngelur përjetësisht në kujtesën tonë, në zemrat tona. Ditët e muajt rrodhën dhe përfunduar me sukses studimet në vitin e parë të shkollës dhe u kthyem për pushime në atdhe. Pas pushimeve u rikthyem në Stamboll për të vijuar studimet në vitin e dytë, por aty mësuam për një aksident ajror ku ishte rrëzuar një helikopter dhe kishin humbur jetën dy shokët tanë studentë Major Tebernuş Özler dhe Kapiten Ersan Dağ, por ishte plagosur rëndë dhe luftonte për jetën edhe shoku im i bankës Kapiten Harun Akshit. Ngelëm zemërdërmuar për ditë e muaj të tërë se Harun Akshit mbijetoi vetëm për pesë muaj dhe u shua përgjithmonë në moshën 32 vjeçare në kulmin e rinisë dhe aftësive të tij ushtarake, duke ngelur me emrin “Shehit/Dëshmor i Atdheut të tij, në kursin e 142-të të studentëve ushtarakë, që prej themelimit të Akademisë së forcave tokësore në vitin 1834. Në pikëpamje

NGA TIRANA NË STAMBOLL: Një miqësi, një sakrificë, një përjetësi - Kapiten Harun Akshit



të arsimit ushtarak është për t'u përmendur se Akademia e Luftës Tokësore e Turqisë është një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit ushtarak turk, me një histori të gjatë që lidhet me modernizimin e ushtrisë osmane dhe më pas të Forcave të Armatosura Turke. Fillimet e saj datojnë në vitin 1834, gjatë periudhës së reformave të Perandorisë Osmane, kur u themelua një shkollë për përgatitjen profesionale të oficerëve të ushtrisë tokësore, ku qëllimi kryesor ishte krijimi i një trupe oficerësh të arsimuar sipas modeleve moderne evropiane e kryesisht sipas modelit gjerman. Gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, akademia luajti rol të rëndësishëm në formimin e shumë komandantëve të ushtrisë. Pas shpalljes së Republikës së Turqisë moderne, më 29 tetor 1923, nga Mustafa Kemal Atatürk, ky moment shënoi fundin e Perandorisë Osmane dhe fillimin e një shteti kombëtar laik, me Atatürkun si presidentin e parë, duke nisur reforma të gjerë për modernizimin e vendit. Por një ndër reformat e para ka qenë edhe reformimi i institucionit arsimor ushtarak që u përshtat me strukturën e re të shtetit modern turk. Akademia vazhdoi të zhvillohej si një qendër e avancuar për edukimin ushtarak, ku kadetët marrin formim akademik, fizik dhe profesional për t'u bërë oficerë të ushtrisë tokësore. Në periudha të ndryshme, akademia ka ndryshuar vendndodhje dhe organizim, por ka ruajtur gjithmonë rolin e saj themelor në përgatitjen e elitës ushtarake. Sot ajo funksionon në kuadër të Universitetit ushtarak kombëtar që prej vitit 2016 si dhe vazhdon të ofrojë arsim të lartë ushtarak, duke kombinuar traditën historike me teknologjitë dhe doktrinat moderne të mbrojtjes. Institucioni ka kontribuar në formimin e shumë gjeneralëve dhe drejtuesve ushtarakë të të gjithë niveleve që kanë pasur ndikim të madh edhe në historinë dhe sigurinë e shtetit turk. Marrja e këtij arsimit ose sikurse e quajnë turqit “kurmay”/oficer shtabi dhe shenja “kërmizë”/ e kuqe në jakën e xhaketës flet shumë

për shkallën e lartë aristokratike të oficerit të shkallës më të lartë të cilën e arrin vetëm elita reale ushtarake turke. Në këtë elitë përfshihen edhe tre shokët tanë dëshmorë: kapiten Harun Akshit, kapiten Ersan Dağ dhe majori dëshmor Tebernuş Özler.

Shokët tanë studentë të Akademisë së Luftës Tokësore, Dëshmorë të Turqisë

Kapiten Harun Akshit – simbol i sakrificës dhe i miqësisë ndërmjet popujve u lind më 5.8.1967 në Denizli. Ai u diplomua në Shkollën e lartë ushtarake të Ankarasë në vitin 1989, në moshën 22-vjeçare, me rezultate të shkëlqyera. Pas tre vitesh, më 1991, përfundoi Kursin Bazë të Oficerit të Xhandarmërisë. Pas konkurrimit me sukses fitoi të drejtën e studimeve në Akademinë e Luftës Tokësore nga 1.10.1998 deri kur u shua nga rënia e helikopterit ditën e mërkurë, më 15 shtator 1999, që ishte një mision në mesin e pushimeve ndërmjet vitit të parë dhe të dytë, pasi rezultatet e vitit të parë të Akademisë së Luftës tokësore i kishte të shkëlqyera. Kapiten Harun Akshit kishte shërbyer më parë edhe në Ankara për tre vite si dhe në Lindje në Van për katër vite. Më 15.9.1999, ai u plagos kur helikopteri ushtarak në të cilin ishte në detyrë u rrëzua pranë distriktit Pervari të provincës Siirt. Ai u dërgua në Spitalin Ushtarak “Gata” (Akademia ushtarake Mjekësore e Gylhanes) për trajtim, por nuk mundi t’iu mbijetojë plagëve dhe u shua ditën e diel, më 30 janar 2000, si dhe është varrosur në Varrezat e Dëshmorëve Ushtarakë në Cebeci/ (Xhebexhi) në Ankara. Ka lënë mbresa bashkëshorten doktoreshë Meltem Akshit, si dhe djalin e tij Kemal Akshit, që lindi kur ndërroi jetë dëshmori Harun Akshit. Emri i dëshmorit Kapiten Harun Akshit është përjetësuar në Akademinë e Luftës Tokësore në Yeni Levent të Stambollit, një sallë mësimore është emëruar me emrin

e tij; ndërsa një qendër konferencash ka marrë gjithashtu emërtimin “Dëshmori Kapiten Harun Akshit”.

Kapiten Ersan Dağ i lindur në Malatya në vitin 1968, diplomuar në Shkollën e Mesme Yerköy/ Yozgat, më 1984, dhe më tej përfundoi Shkollën e lartë ushtarake në Ankara, më 1988, si studenti më i mirë në transportit, ndoqi studimet në Akademinë e Luftës Tokësore nga 1.10.1998 deri kur u shua nga rënia e helikopterit, më 15 shtator 1999. Në Akademinë e Luftës Tokësore në Yeni Levent të Stambollit një sallë mësimore është emëruar me emrin e tij. Eshtrat e tij prehen në Varrezat e Dëshmorëve Ushtarakë në Cebeci/ (Xhebexhi), Ankara.

Major Tebernuş Özler i lindur në Kahramanmaraş, më 1.3.1963, ndërsa në vitin 1980, kur ishte në moshën 17-vjeçare përfundoi Shkollën e Mesme Ushtarake në “Kuleli” në Stamboll. U diplomua në Shkollën e lartë ushtarake në Ankara, më 1984, si studenti më i mirë në klasën e Artilerisë. Pas konkurrimit me sukses fitoi të drejtën e studimeve në Akademinë e Luftës Tokësore nga 1.10.1998 deri kur u shua nga rënia për shkak të një defekti Teknik të helikopterit ushtarak, më 15 shtator 1999, pranë rrethit Pervari të provincës Siirt. Shkolla e Mesme në Kahramanmaraş mban emrin e tij: “Dëshmori Tebernüş Özler”, një rrugë në Kahramanmaraş është emërtuar “Rruga Dëshmori Major Tebernüş Özler”, në Akademinë e Luftës Tokësore në Yeni Levent të Stambollit një sallë mësimore është emëruar me emrin e tij. Platforma e Helikopterëve të Shtabit të Përgjithshëm në Ankara është emëruar me emrin e tij: “Dëshmori Tebernüş Özler”. Eshtrat e tij gjenden në Varrezat e Dëshmorëve Ushtarakë në qytetin e Balıkesirit. Emrat e të tre shokëve tanë dëshmorë Kapiten Harun Akshit, kapiten Kapiten Ersan Dağ e Major Tebernuş Özler janë të gdhendur me shkronja të arta në kolonat e Akademisë së Luftës Tokësore si brezi i 142 i studentëve, sikurse janë të gdhendur gjithë emrat e studentëve që kanë studiuar në këtë Akademi, që prej vitit të krijimit pothuaj rreth dy shekuj më parë, ku breza të shumtë kanë luftuar për Atdheun e tyre në dhjetëra luftëra, sikurse ka edhe me qindra dëshmorë të tjerë që kanë shkruar epope ndër breza.

Kapiten Harun Akshit

Pas humbjes së jetës së Pilotit të Xhandarmërisë, Kapiten Harun Akshit, në rajonin Köprüçay të rrethit Pervari të Siirtit, më 30 janar 2000, ka lënë mbrapa bashkëshorten Dr. Meltem Akshit, djalin e tij Kemal Akshit, miq e shokë të shumtë që e kujtojnë gjithmonë shpirtin e martirit të tyre të dashur, që sakrifikoi jetën e tij për Atdheun, për kombin e tij. Familjen e tij në vijueshmëri edhe sipas të dhënave të rrjeteve sociale e vizitojnë personeli i pilotëve të Xhandarmërisë, shokë e miq të dëshmorit, pjesëtarë të Shoqatës Turke të Veteranëve të Invalidëve të Luftës, Vejushave të Dëshmorëve, Myftiu i Pamukkalesë, zyrtarët fetarë, etj.

Meltem Akshit, bashkëshortja e Kapitenit të Shtabit të Pilotëve të Xhandarmërisë, i lindur në Denizli, Harun Akshit, pas rrëzimit të helikopterit ushtarak pranë Distriktit Pervari të Siirt, më 30 janar 2000, pavarësisht pikëllimit të saj të madh, nuk e humbën entuziazmin dhe kurajën për jetën duke u kapur fort pas rritjes dhe edukimit të djalit të dëshmorit, Kemalit, i cili tani është 26 vjeç. Kemal Akashit është djalë dëshmori. Vite më parë nëna e tij, bashkëshortja e dëshmorit shprehej: “Dua që Kemali të rritet e edukohet si dhe të bëhet ushtarak si babai..”, edhe pse rrjedhat e jetës janë të ndryshme. Në atë fund janari të vitit 2000 zemrat tona ngrinë për një çast për humbjen e shokut tonë Kapitenit të dashur, njerëzor e miqësor me bashkëkombësit, por edhe me ne që përfaqësonim shtetet miq e partner të Turqisë.

Ne përkujtojmë Kapitenin Pilot të ri të Xhandarmërisë Harun Akshit nga Denizli, si një mik shumë të dashur, të afërueshëm të komunikueshëm, që të ftonte në shtëpi të tij, pas mësimit. Jeta e tij ishte e pandarë nga jeta e të gjithë neve, ndërkohë që në të gjitha shkollat e larta pasuniversitare të Stambollit kishte në atë periudhë 72 të huaj nga 45 vende të botës. Fakt është se në ditën e rënies së helikopterit ishin tre shokë, tre pilotë, që janë sot që të tre dëshmorë (shehit): Në ato ditë të ikjes së parakohshme të kapitenit Harun Akshit hodha disa vargje poetike zemre, për këtë mik e shok të ngushtë e të sinqertë, tepër miqësor, që shoqërinë dhe miqësinë e çmonte, e vlerësonte dhe e respektonte. Nuk mund të gjenden fjalë as te fjalorët më të mirë të botës që të përshkojnë mirësinë e një njeriu të veshur me të gjitha mirësitë e botës, dhe për më tepër që ai ishte një botë më vete e mirësisë njerëzore.

Kapiten Harun Akshit

Një çerekshekulli dhe përgjithmonë në zemrat e shokëve

Kapiten Harun Akshit

Një çerekshekulli më parë në “Revistën e Xhandarmërisë/ Jandarma dergisi” dhe në Buletinin e Akademive të Luftës së Turqisë/ “Harp Akademileri Bulteni”, Temuz-/Korrik 2000, publikova, në original:

Olağanüstü Hal Bölgesi’nde Tugay karargahında fiili çalışma stajımı icra ederken 15 Eylül 1999 günü meydana gelen helikopter kazasında şehit düşen J.Pl’t. Yzb.Harun Akshit’in Kara Harp Akademisi’ndeki sınıf arkadaşı Arnavut kökenli P.Yb.Zaho Golemi’nin çok sevdiği arkadaşı için yazdığı şiir.

Şehit Yüzbaşı Harun Akshit Benim Şehit Arkadaşıma
Damla damla yaş akıyor gözlerimizden,
Elim bir kaza kopardı seni içimizden,
Altın gibi gülen yüzünle,
*Herkes**e açık saf kalbinle,*
Sen ölmedin hala aramızdasın,
*Bizimle birlikte sen de mezu**n olacaksın.*

Şimdi ruhun göklerde bir bayrak,
Şimdi kalbin sınırda bir kale,
Şimdi sen milletin kalbinde bir ruh,
Gönüllerde yanan bir kor’sun,
Şehitlik içimizdeki en büyük özlem,
O ancak sana layık.
Vatan en değerli varlık,
Sen O’nu korumak için and içtin,
(yemin ettin),
Sen ölmedin, Vatanın bağrında yeniden yeşeren,
En hakiki ordunun saflarında genç bir subaysın.
Zaho Golemi P.Yb. Kara Harp Akademisi 2 nci Sınıf Öğrencisi Arnavutluk Kara Kuvvetleri
Not: Sınıf ve sıra arkadaşım şehit Yzb. Harun Akshit’in anısına...sayfa 254.

E përkthyer në gjuhën shqipe:
“Kjo është një poezi e shkruar nga nënkolonel Zaho Golemi, me origjinë shqiptare, shok klase i Kapiten Harun Akshit në Akademinë e Luftës Tokësore Turke, për shokun e tij të dashur që ra dëshmor në një rrëzim helikopteri, rrëzim që erdhi si pasojë e një mosfunksionimi teknik gjatë një misioni fluturimi, më 15 shtator 1999, ndërsa kryente stërvitjen e tij praktike në Shtabin e Brigadës në Zonën e Gjendjes së Emergjencës”.

Kapiten Harun Akshit

Për shokun tim dëshmor, kapiten Harun Akshit

Kapiten Harun Akshit

Lotët na rrjedhin vilarë në sytë tanë,
Aksident i tmerrshëm të ndau nga ne,
Fytyra jote e artë e buzëqeshur gjithmonë,
Zemra jote e pastër e qelibartë, e hapur për të gjithë,
Ti nuk ke vdekur, je i gjallë mes nesh,
Ti je në rresht dhe do diplomohesh bashkë me ne.
Shpirti yt është në valët e flamurit në qiell,
Zemra jote është e fortë e pandalshme s’ka kufi,
Shpirti tënd jeton në zemër të kombit,
Ti je prush i ndezur në zemrat tona,
Ti je shoku ynë dëshmor dhe malli më i madh në zemër shokësh,
Ti je bir i denjë i kombit tënd.
Atdheu është pasuria jote më e çmuar,
Ti je betuar në mbrojtje të tij,
Nuk ke vdekje kurrë, je gjithmonë në radhët tona,
Je dëshmor i rilindur në zemër të Atdheut.
Nënkolonel Zaho Golemi, viti i dytë, Akademia e Luftës Tokësore “Yeni Levent” Stamboll.
Student i Forcave të Armatosura të Shqipërisë
Shënim: Në kujtim të shokut të klasës dëshmorit Kapiten Harun akshit...f. 254.

Kapiten Harun Akshit

Nderimi që i bën kombi turk dëshmorëve / “Şehit”-ëve

Kapiten Harun Akshit

Vlerësimi që Turqia dhe populli turk i bëjnë dëshmorëve të kombit të tyre është jashtëzakonisht i lartë, emocional, i rrënjosur thellë në identitetin kombëtar, historik e fetar të vendit. Kështu në shoqërinë turke, “şehit” (dëshmor) ka një status të shenjtë, të respektuar si hero kombëtar dhe besimtar i rënë për Atdheun dhe Zotin. “Şehit” (dëshmor) vjen nga arabishtja/persishtja dhe do të thotë “dëshmitar” (i besimit), dhe ka kuptim të dyfishtë: kombëtar dhe fetar. Dëshmori është njeri i shenjtë që sakrifikon jetën për vendin, flamurin dhe besimin fetar. Fjala “Şehitler ölmez, vatan bölünmez”/(Dëshmorët nuk vdesin, Atdheu nuk ndahet), ndërsa 18 Marsi është dita e Dëshmorëve për nder të fitores së betejës së famshme të Çanalkalesë, “Çanakkale Zaferi ve Şehitleri Anma Günü”, që përkujton betejën e famshme të Çanakalasë, më 1915, gjatë Luftës së Parë Botërore. Në këtë ditë nuk rreshtin ceremonitë shtetërore e ushtarake në të gjithë vendin, me pjesëmarrjen e Presidentit, Forcave të Armatosura dhe qytetarëve. Nderimi dhe respekti për dëshmorët është masiv në shkolla, ku nxënësit recitojnë poezi për dëshmorët, vizitojnë varrezat ushtarake dhe mësojnë për sakrificën e tyre. Ndërsa 30 gushti është dita e “Zafer Günü”/dita e fitores që përkujtohet me madhësihti. Në Turqi ndodhen me dhjetëra varreza dëshmorësh (şehitlik), ku prehen ushtarë dhe qytetarë të vvarë në luftëra apo sulme terroriste. Vetëm në kryeqytetin Ankara ka dy varreza të dëshmorëve të kombit turk, por monumenti i dëshmorëve të Çanakalasë në Gallipoli është një nga vendet më të vizituara në botë, një simbol i krenarisë kombëtare dhe i fitores së madhe të vitit 1915 ndaj disa ushtrive njëherazi. Në Gallipoli janë varrezat e shtatë ushtrive si dhe qindra shehitë të kombit shqiptar të rënë në luftë për mbrojtjen e Çanakalasë me rreth 26 mijë të rënë.

Në Ankara aty ku prehet edhe shoku ynë kapiten Harun Akshit, ka dy varreza dëshmorësh, por varreza dëshmorësh ka edhe në Stamboll dhe në qytete të tjera të Turqisë, ku gjenden edhe monumente madhështore, ku zhvillohen homazhe. Në Izmir është një monument që quhet “İlk Kurshun”/plumbi i parë, që i kushtohet luftës së madhe patriotike që e pritën grekun me pushkë dhe triumfuan mbi të. Respekti për familjet e dëshmorëve në Turqi është i jashtëzakonshëm, pasi u jepen familjeve të tyre nga shteti përfitime ekonomike, banesa, punësime publike dhe kujdes i veçantë shëndetësor e social. Gjatë fjalimeve politike e ushtarake, përmendja e nënave të dëshmorëve (şehit anneleri) përcillet me emocione të mëdha dhe duartrokitje. Nënë dëshmori është një krenari kombëtare e jashtëzakonshme. Edhe në xhami luten shpesh për shpirtrat e dëshmorëve, duke i konsideruar si të pavdekshëm në sytë e Zotit. Sipas traditës islame, “një dëshmor hyn në xhenet pa gjykim”, gjë që e rrit ndjenjën e nderimit dhe krenarisë. Në media dhe arsimin publik, dëshmorët përshkruhen si modele të larta morali dhe

sakrifice, shpesh me portrete dhe histori të tyre. Janë me dhjetëra thëniet për dëshmorët: “Vatan için canını veren her kişi şehittir” (kushdo që jep jetën për atdhe, është dëshmor); “Bayrakları bayrak yapan üstündeki kandır; Toprak eğer uğrunda ölen varsa vatandır”, Mithat Cemal Kuntay (Ajo që e bën flamurin flamur është gjaku që është derdhur mbi të; toka bëhet Atdhe vetëm kur dikush ka vdekur për të). Turqia e konsideron dëshmorin si themel të lirisë, nderit dhe unitetit kombëtar, ku nderimi për dëshmorët është institucional, kulturor, fetar dhe emocional, si dhe përfaqëson një nga shtyllat më të forta të identitetit dhe moralit kombëtar turk.

Kapiten Harun Akshit

Atdheu i pandashëm, populli i pavdekshëm, amaneti i patretshëm!

Kapiten Harun Akshit

Kapiten Harun Akshit, kapiten Kapiten Ersan Dağ e Major Tebernuş Özler nuk janë më midis nesh por janë në piedestalin e lirisë të kombit turk. Por shokët tanë në Stamboll ishin edhe plot student të tjerë të KHA-së si: Sadëk Koroglu, Ali Këlëcaslar, Ufuk Uras, Ismail Shanlië, Shenol Mavi, Irfan Ozsert, Fikret Savash, A. Can Çevik dhe shumë të tjerë, por edhe amerikani Robert White, Ltc. Peryman, etj., plot 98 studentë për oficerë shtabi të ndarë në katër grupe mësimorë. Për dëshmorët kanë komente të shumta edhe në rrjetet sociale turke edhe pas një çerek shekulli, për përjetësinë dhe pavdekësinë e heronjve dhe dëshmorëve të Atdheut të vet, sikurse janë komentuesit Kadir Özkan, Ismail Atalay, Davut Gül, Osman Akdeniz, Fethi Yıldız, Jale Güneş, Safiye Aydın.. etj. Zoti iu dhëntë parajsën dhe prehjen në paqe inshallah, por edhe, durimi dhe kuraja për familjarët për njerëzit e tyre të dashur. Ja çfarë shkruhet në një postim në përvjetorin e rënies së dëshmorit më 30 janarin e vitit 2024: “Vëllai ynë i çmuar, dëshmori kapiten Harun Akshit, në 24-vjetorin e martirizimit të tij, ne, si një grup shokësh të tij, së bashku me personelin e Komandës së Grupit Ajror të Xhandarmërisë, përkujtuam Harun Akshit-in në varrin e tij në Varrezat Ushtarake “Cebeci” në Ankara, me respekt, mirënjohje dhe lutje. Shpirti i tij u prehtë në paqe dhe u prehtë në Parajsë. Me këtë rast, ne kujtojmë edhe një herë me mirënjohje udhëheqësin tonë të madh, komandantin tonë të përjetshëm dhe të vetëm Gazi Mustafa Kemal Atatürk, dhe të gjithë martirët tanë të Atdheut, dhe përulemi me respekt para shpirtrave të tyre të shenjtë. Shpirtrat tuaj u prehshin në paqe dhe ju qofshin në Parajsë”. Një dedikim i ndjerë për shokun e tyre pilot. Nga rrjetet sociale turke gjejmë se në të njëjtën datë me dëshmorin Harun Akshit kanë rënë në kohë të ndryshme edhe pesë dëshmorë të tjerë si, Şehit Tpç. Er. Bekar Aktunç (rënë më 30.01.1985), Şehit Tnk. Ütgm. Arif Bülent Kızıldemir (rënë më 30.01.1993), Şehit Polis Memuru Mustafa Yılmaz (rënë më 30.01.2012), Şehit P. Uzm. Çvs. Selçuk Paker (rënë më 30.01.2016), Şehit P. Uzm. Çvs. Adem Aktaş (rënë më 30.01.2016). “Për Heronjtë e dëshmorët që ranë për Atdheun, më 30 janar, shkruhet e përkujtohen në çdo vit, kur mbërrin 30 janari, me një dhembje zemrash, sepse në këtë ditë dhe në të gjitha ditët që kanë rënë dëshmorë janë ditë që kujtohen burrat e guximshëm që sakrifikuan jetën e tyre për Atdheun. Dëshmorët janë më shumë se një emër pasi dhimbja për ta digjet në zemrën e një nëne, malli për ju është një përzierje krenarie dhe pikëllimit në zemrën e një babai, prandaj ju jeni përjetësi në gjurmën e pavdekësisë së një kombi”, shkruhet në mjaft dedikime për dëshmorët.


Ndërsa në shumë të tjera flitet në këtë gjuhë: “Ju qëndruat të vendosur dhe burrërisht për Atdheun tuaj..., ju ishit dhe mbetët shpresë përjetësie, guxim dhe shembull frymëzimi në breza, ju ecët në përjetësi me martirizim, duke u bërë yje në qiell, prandaj dhe vendi juaj është në parajsë duke mos u harruar kurrë. Populli dhe Atdheu nuk lejon kurrë harrimin tuaj sepse dëshmorët nuk vdesin kurrë, Atdheu është i pandashëm, populli është i pavdekshëm, amaneti i patretshëm”. Republika Turke dëshmorët i konsideron themel të lirisë, nderit e unitetit kombëtar, ku nderimi për ta është institucional, kulturor, fetar e emocional dhe përfaqëson një nga shtyllat më të forta të identitetit dhe moralit kombëtar të tyre. Në një vizitë që Komanda e kurseve të ish-AU “Skënderbej” zhvilloi në Ankara nga data 5 deri më 8 nëntor 2003, kërkoi një ndryshim në programin e vizitës dhe të shtohej një vizitë në Varrezat e Dëshmorëve Ushtarakë në Cebeci/ (Xhebexhi) në Ankara, ku prehet dëshmori kapiten Harun Akshit. Delegacioni përbëhej nga Zaho Golemi, Suzana Jahollari, student Arjan Sopiqoti nga Fieri, Selvi Thanà nga Skrapari, Bledar Dora nga Konispoli. Përgjigjia e komandantit të Kara Harp Okullu/Shkollës së Lartë Ushtarake të Ankarasë, Gjeneralmajor Hulusi Akar Tümgeneral Hulusi Akar, shërbeu edhe si Shefi i 29-të i Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë (2015–2018), Ministër i Mbrojtjes Kombëtare i Turqisë (2018–2023), ndërsa më 2023, hyri në politikë duke u bërë anëtar i Parlamentit Turk). Fakt është se pritja e delegacionit shqiptar ishte e menduar dhe emocionale pasi u shpreh: “Nuk ka nder më të madh se një i huaj të vizitojë varrezat e dëshmorëve të Turqisë, sepse ne dëshmorët i kemi themelin e lirisë, nderit dhe unitetit kombëtar. Nuk gjej fjalë për t’ju falënderuar delegacionin ushtarak shqiptar”. Ndërsa kur i fola për publikimin që kisha bërë për dëshmorin në revistën turke, të nesërmen shkrimin e gjeta në kornizë përbri portës hyrëse të komandantit të Akademisë. Nderimi për të rënët është ndër nderimet më sublime që popujt, kombet shtetet u rezervojnë dëshmorëve.

2026 – Viti i Paralajmërimit të Njerëzimit

Një vit që na vë përballë vetes

Ka vite që mbartin një simbolikë të veçantë, dhe 2026 është një prej tyre. Jo sepse është thjesht një numër në kalendar, por sepse është vit i parashikuar nga fizikanit Heinz von Foerster si një pikë kritike për njerëzimin. Ai paralajmëroi se rritja e pandalshme e popullsisë, e kombinuar me kufizimet e burimeve, do të sillte një krizë globale. Sot, kur shohim realitetin e shpyllëzimit, ndryshimeve klimatike, urbanizimit të pakontrolluar dhe krizës ushqimore, ky paralajmërim tingëllon më pak si fantashkencë dhe më shumë si një thirrje urgjente për reflektim.

Ky vit nuk është thjesht një datë e shënuar në kalendar, por një simbol i përplasjes mes rritjes së pandalshme të popullsisë dhe kufijve të planetit. Nëse nuk veprojmë, mund të përballemi me një krizë të përmasave që nuk i kemi parë kurrë më parë.



Trashëgimia e Malthus dhe matematika e von Foerster

Që në shekullin XVIII, Thomas Malthus paralajmëroi se popullsia gjithmonë rritet më shpejt se furnizimi me ushqim. Von Foerster, shekuj më vonë, e përforcoi këtë ide me llogaritje matematikore, duke parashikuar një “doomsday” në vitin 2026. Në thelb, të dy na kujtojnë se rritja e pakontrolluar nuk është thjesht një fenomen demografik, por një kërcënim ekzistencial.

Matematika e von Foerster nuk ishte thjesht një lojë teorike: ajo tregonte se nëse trendet vazhdonin pa ndërhyrje, sistemi global do të arrinte një pikë ku nuk do të mund të mbante më ekuilibrin mes njerëzve dhe burimeve. Ky paralajmërim nuk është një profeci mistike, por një analizë e ftohtë e të dhënave, e cila na paralajmëron për rrezikun e një krize të pashmangshme nëse nuk ndryshojmë kursin.

Pasojat e rritjes së pakontrolluar

Nëse nuk veprojmë, pasojat janë të qarta dhe të shumëfishta:

- Mjedisi: humbja e biodiversitetit, shkatërrimi i ekosistemeve dhe përshpejtimi i krizës klimatike.
- Ekonomia: pabarazi të thella, presion mbi tregjet e punës dhe shpërndarje e padrejtë e pasurisë.
- Shoqëria: konflikte mbi aksesin në ujë, energji dhe ushqim, duke rritur rrezikun e destabilizimit global.

Këto pasoja nuk janë thjesht teori. Ato tashmë po ndodhin, dhe 2026 shihet si një vit ku mund të përplasen të gjitha këto kriza në një pikë të vetme. Urbanizimi i pakontrolluar po krijon qytete të mbipopulluara, ku infrastruktura nuk arrin të përballojë kërkesat. Shpyllëzimi po zhduk ekosisteme të tëra, duke rrezikuar biodiversitetin. Ndryshimet klimatike po sjellin thatësira, përmbytje dhe fenomene ekstreme që kërcënojnë prodhimin ushqimor.

Debati mbi kontrollin e popullsisë

Von Foerster riktheu në vëmendje diskutimet mbi menaxhimin e popullsisë. Nga përdorimi i kontraceptivëve deri te ideja e një “people-stat” – një mekanizëm rregullues për popullsinë – dilemat etike janë të mëdha. A duhet të kufizohet liria individuale për të siguruar mbijetesën kolektive? Ky është një debat që prek zemrën e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Për disa, kontrolli i popullsisë është një domosdoshmëri; për të tjerë, është një shkelle e papranueshme e lirive themelore. Megjithatë, pyetja mbetet: si mund të sigurojmë që rritja e popullsisë të mos e shkatërrojë planetin? Edukimi mbi planifikimin familjar, akses i barabartë në shëndetësi dhe politika të përgjegjshme janë hapa të domosdoshëm.



Teknologjia, shpëtim apo iluzion?

Përparimet teknologjike kanë shtyrë kufijtë e prodhimit ushqimor dhe energjisë, por ato nuk janë një zgjidhje magjike.

- Bujqësia e gjelbër: kultura të modifikuara gjenetikisht dhe praktika të qëndrueshme për të ushqyer miliarda njerëz.
- Energjia e rinovueshme: kalimi drejt burimeve të pastra për të përballuar kërkesat e një popullsie në rritje.
- Urbanizimi inteligjent: planifikim i qyteteve për të menaxhuar flukset e popullsisë dhe burimet.

Megjithatë, teknologjia pa drejtësi sociale dhe pa menaxhim të qëndrueshëm është thjesht një shtyrje e krizës, jo një zgjidhje. Nëse inovacioni nuk shoqërohet me politika të drejta dhe me shpërndarje të barabartë të burimeve, rreziku mbetet i njëjtë.

Roli i bashkëpunimit ndërkombëtar

Sfida e popullsisë është globale. Nuk ka kufij kombëtarë kur bëhet fjalë për klimën, ujin apo ushqimin. Pa solidaritet ndërkombëtar, pa politika të përbashkëta mbi edukimin, shëndetin dhe shpërndarjen e burimeve, rreziku i përplasjeve

sociale dhe ekologjike është i pashmangshëm. Vetëm një përgjigje e bashkuar mund të sigurojë që rritja e popullsisë të mos kthehet në një katastrofë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është luks, por domosdoshmëri. Pa të, çdo përpjekje e izoluar do të jetë e pamjaftueshme. Kriza e popullsisë është një sfidë që kërkon një përgjigje globale.

Përtej vitit 2026

Edhe pse parashikimi i von Foerster është i frikshëm, historia ka treguar se “ditët e fundit” shpesh nuk realizohen. Por kjo nuk duhet të na bëjë të qetësohemi. Përkundrazi, duhet të na shtyjë të veprojmë. E ardhmja e njerëzimit varet nga zgjedhjet që bëjmë sot: teknologjia e gjelbër, drejtësia sociale dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve janë çelësat për të siguruar një të ardhme të jetueshme.

Ky vit nuk është fundi i botës, por mund të jetë fundi i iluzioneve tona. Nëse nuk veprojmë me mençuri, solidaritet dhe guxim, paralajmërimi i von Foerster mund të kthehet nga teori në realitet.



Sistemet e mbrojtjes ajrore: Teknologjia që po formëson betejat e së ardhmes

Në epokën moderne, mbrojtja ajrore është bërë një fushë ku inovacioni teknologjik përcakton jo vetëm rezultatin e betejave, por edhe ritmin e zhvillimit të ushtrive. Nga radarët e gjeneratës së re te raketat inteligjente dhe sistemet anti-dron, çdo element është pjesë e një arkitekture të ndërlikuar që synon të mbrojë hapësirën ajrore nga kërcënime gjithnjë e më të sofistikuara.

Radarët: Evolucioni nga analogët te inteligjenca kuantike

Radarët janë zemra e çdo sistemi mbrojtjeje ajrore. Teknologjia AESA (Active Electronically Scanned Array) ka sjellë një revolucion, duke lejuar gjurmimin e dhjetëra objektivave njëkohësisht dhe duke zbuluar avionë me gjurmë të reduktuar radarike.

Në laboratorët e avancuar po testohen edhe radarë të bazuar në teknologjinë kuantike, të aftë të dallojnë objektiva që deri më sot kanë qenë të padukshëm për sistemet klasike. Kjo pritet të hapë një epokë të re në zbulimin e raketave hipersonike dhe dronëve të vegjël.

Raketat: Inteligjenca e interceptimit

Raketat moderne nuk janë thjesht projekte mekanike; ato janë platforma të pajisura me sisteme drejtimi të avancuara.

- Interceptuesit me sensorë infra të kuq ndjekin objektivat me saktësi të lartë.

- Raketat me drejtim aktiv radarik komunikojnë me radarët e tokës dhe satelitët për të optimizuar trajektoren.

- Sistemet me motorë të rinj 'ramjet' dhe 'scramjet' po testohen për të përballuar shpejtësitë hipersonike.

Ky zhvillim e bën interceptimin më të besueshëm, edhe kur objektivat lëvizin me shpejtësi të paparashikueshme.

Anti-dronët: Mbrojtja kundër armëve të lira

Dronët kamikaz kanë ndryshuar natyrën e luftës, duke e bërë të domosdoshme krijimin e sistemeve të reja anti-dron.

- Lazerët me energji të lartë shkatërrojnë dronët pa përdorur raketa të kushtueshme.

- Sistemet elektromagnetike ndërhyjnë në komunikimin e dronëve, duke i bërë të paefektshëm.

- Interceptuesit e vegjël janë projektuar posaçërisht për objektiva të vogla, duke ulur kostot e mbrojtjes.

Këto teknologji janë ende në fazë testimi, por pritet të bëhen standard në konfliktet e ardhshme.

Inteligjenca artificiale: Truri i mbrojtjes ajrore

Integrimi i AI-së është një nga zhvillimet më të rëndësishme. Algoritmet e inteligjencës artificiale parashikojnë trajektoren e raketave balistike; analizojnë sjelljen e dronëve në kohë reale dhe optimizojnë përdorimin e interceptuesve, duke ulur kostot dhe rritur efikasitetin.

Në të ardhmen, pritet që sistemet e mbrojtjes ajrore të jenë pothuajse autonome, duke marrë vendime pa ndërhyrjen e njeriut, por gjithmonë nën mbikëqyrje njerëzore për të shmangur rreziqet etike.

Sfida e raketave hipersonike

Raketat hipersonike janë një nga sfidat më të mëdha teknologjike. Ato lëvizin me shpejtësi mbi pesë herë më të madhe se ajo e zërit dhe ndjekin trajektore të paparashikueshme. Për t'i përballuar, po zhvillohen:

- Radarë të rinj kuantikë me aftësi gjurmimi më të avancuar.

- Interceptues me motorë scramjet, të aftë të arrijnë shpejtësi të krahasueshme me objektivat.

- Algoritmet të AI-së që parashikojnë lëvizjet e raketave në kohë reale.

Kjo është një garë teknologjike ku çdo sekondë ka rëndësi.

Teknologjitë eksperimentale

Përveç sistemeve aktuale, po testohen edhe teknologji eksperimentale që mund të ndryshojnë rrënjësisht mbrojtjen ajrore:



- Armët me energji drejtpërdrejtë (Directed Energy Weapons), si lazerët dhe mikrondet e fuqishme.

- Sistemet satelitore të mbrojtjes, që krijojnë një rrjet global zbulimi dhe interceptimi.

- Radarët kuantikë dhe sensorët optikë të avancuar, të aftë të dallojnë objektiva në kushte atmosferike të vështira.

Këto teknologji janë ende në fazë zhvillimi, por pritet të jenë pjesë e arsenalit të mbrojtjes ajrore në dekadat e ardhshme.

Mbrojtja ajrore është sot një fushë ku teknologjia përcakton fatin e betejave. Radarët AESA, raketat inteligjente, sistemet anti-dron dhe integrimi i inteligjencës artificiale po e transformojnë mënyrën se si mbrohet hapësira ajrore. Sfida e raketave hipersonike mbetet e hapur, por inovacioni i pandalshëm tregon se mbrojtja ajrore e së ardhmes do të jetë një kombinim i teknologjive të avancuara, ku shpejtësia, saktësia dhe inteligjenca do të jenë çelësat e suksesit.

Sistemet e mbrojtjes ajrore: Automatizimi dhe robotika si faza e re e teknologjisë

Mbrojtja ajrore nuk është më thjesht një kombinim radarësh dhe raketash; ajo po shndërrohet në një ekosistem të automatizuar ku robotika dhe inteligjenca artificiale luajnë rol qendror. Automatizimi i plotë i sistemeve mbrojtëse është një nga drejtimet më të rëndësishme të zhvillimit, sepse shpejtësia e reagimit është kritike dhe njeriu shpesh nuk mund të marrë vendime në kohën e duhur përballë raketave hipersonike apo dronëve të shumtë.

Automatizimi i qendrave të komandës

Qendrat e komandës moderne nuk janë më të varura vetëm nga operatorët njerëzorë.

- Sistemet e automatizuara të vendimmarrjes analizojnë të dhënat e radarëve dhe sensorëve në kohë reale.

- Algoritmet e AI-së vendosin se cilat raketa interceptuese duhet të përdoren, duke optimizuar kostot dhe duke shmangur mbingarkimin e sistemit.

- Simulimet e vazhdueshme ndihmojnë në parashikimin e

skenarëve të mundshëm, duke e bërë mbrojtjen më elastike.

Robotika në terren

Përveç automatizimit të komandës, robotika po hyn fuqishëm në fushën e mbrojtjes ajrore: Dronët mbrojtës që patrollojnë hapësirën ajrore dhe ndërhyjnë kundër dronëve sulmues. Robotët tokësorë që transportojnë dhe vendosin bateritë e raketave në pozicione të reja pa rrezikuar jetën e ushtarëve. Sistemet autonome të mirëmbajtjes, të afta të diagnostikojnë defektet dhe të kryejnë riparime bazike pa ndërhyrje njerëzore.

Integrimi me rrjetet satelitore

Automatizimi nuk kufizohet vetëm në tokë. Satelitët e mbrojtjes ofrojnë një panoramë globale të hapësirës ajrore. Komunikimi i automatizuar mes satelitëve dhe qendrave tokësore siguron që informacioni të shpërndahet menjëherë. Sistemet e navigimit të avancuar ndihmojnë raketat interceptuese të ndjekin objektivat me saktësi të lartë, edhe kur ato lëvizin në trajektore të paparashikueshme.

Sfida e etikës dhe kontrollit

Automatizimi i plotë sjell edhe dilema teknologjike:

- A duhet që një sistem mbrojtjeje të marrë vendime pa ndërhyrjen e njeriut?

- Si sigurohet që algoritmet të mos bëjnë gabime fatale?

Për këtë arsye, shumica e sistemeve moderne janë të ndërtuara mbi parimin e mbikëqyrjes njerëzore, ku AI-ja merr vendime të shpejta, por njeriu ka gjithmonë fjalën e fundit.

Automatizimi dhe robotika po e çojnë mbrojtjen ajrore në një nivel të ri. Nga qendrat e komandës inteligjente te dronët mbrojtës dhe satelitët e integruar, teknologjia po krijon një arkitekturë ku shpejtësia, saktësia dhe autonomia janë çelësat e suksesit. Në të ardhmen, mbrojtja ajrore do të jetë një sistem pothuajse i vetëdrejtuar, ku njeriu do të ketë rolin e mbikëqyrësit, ndërsa teknologjia do të mbajë barrën e reagimit të menjëhershëm.



Qendra e Personel Rekrutimit njofton se ka filluar regjistrimin e kandidatëve për **200 (dyqind) ushtarë/detarë aktivë**, të cilët do të shërbejnë në funksione dhe vend-dislokime sipas nevojave të Forcave të Armatosura.

Periudha e Stërvitjes

Stërvitja Individuale Bazë do të zhvillohet nga **18 maj deri më 24 korrik 2026**, në qendrat e përcaktuara të trajnimit. Kandidatët e përzgjedhur do të përgatiten për të përballuar sfidat e shërbimit aktiv dhe për të kontribuar në mbrojtjen e vendit.

Afati i Dokumentacionit

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm duhet të bëhet deri më **17 prill 2026**.